

PLANI VENDOR

I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

BASHKIA TEPELENË

Tabela e përmbajtjes

1.HYRJE	4
2.KONTEKSTI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE (MIM)	5
2.1 Vëzhgim i përgjithshëm mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve.....	5
2.2 Korniza ligjore dhe e politikave	6
2.2.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032	8
2.2.3 Legjislacioni kombëtar për mbetjet	9
2.3 Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor	13
2.3.1 Niveli kombëtar	13
2.3.2 Niveli rajonal.....	14
2.3.3 Niveli vendor	14
3.KONTEKSTI VENDOR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA	15
3.1 Profili zhvillimor i Bashkisë	15
3.1.1 Pozita gjeografike e Bashkisë.....	15
3.1.2 Demografia.....	18
3.1.3 Zhvillimi ekonomik.....	19
3.2.Sistemi dhe praktikat aktuale të menaxhimit të mbetjeve	20
3.2.1 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki.....	20
3.2.2 Prodhimi dhe përbërja e mbetjeve.....	22
3.2.3 Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve (kontenierët, itineraret).....	23
3.2.4 Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve.....	27
3.2.5 Depozitimi i mbetjeve	27
3.2.6 Riciklimi.....	28
3.2.7 Mbetjet e biodegradueshme.....	28
3.2.8 Rrymat e tjera të mbetjeve	29
3.3 Ekonomia dhe financimi i menaxhimit aktual të mbetjeve	30
3.3.1 Buxheti vjetor dhe investimet	30
3.3.2 Ndarja e kostove.....	30
3.3.3 Tarifat dhe të ardhurat e planifikuara	32
3.4 Indikatorët e performancës.....	34
3.5 Ndërgjegjësimi i publikut dhe shmangia e mbetjeve.....	35
4. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE MBETJEVE.....	41
4.1 Fushëveprimi i planit vendor të MIM	41

4.1.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM)	42
4.1.3 Parashikimi i popullsisë	42
4.1.4 Parashikimi i volumeve.....	43
4.2 Kuadri Strategjik	46
4.2.1 Vizioni	46
4.3 Objektivat strategjikë.....	46
4.3.1 Objektivi strategjik 1: Parandalimi i krijimit të mbetjeve	47
4.3.2 Objektivi strategjik 2: Menaxhimi i integruar mjedisor i mbetjeve bashkiake në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me komunitetin, sektorin privat dhe shoqërinë civile.....	49
4.3.3 Objektivi strategjik 3: Forcimi i kapaciteteve institucionale, administrative dhe teknike të Bashkisë Tepelenë për menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve dhe zhvillimi i kuadrit rregullator në përputhje me legjislacionin.....	59
4.3.4 Objektivi strategjik 4: Qëndrueshmëria financiare e shërbimeve të MIM përmes një administrimi eficient të shërbimeve, duke garantuar vlerën e kostos dhe përballueshmërinë e pagesës së tarifës.	61
4.3.5 Objektivi strategjik 5: Forcimi i kulturës së reduktimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe bizneseve	65
5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE	70
5.1 Qëllimi dhe kuadri i monitorimit.....	70
5.2 Organizimi institucional	70
5.3 Sistemi i monitorimit	Error! Bookmark not defined.
5.4 Treguesit e monitorimit	70
5.5 Burimet e të dhënave.....	Error! Bookmark not defined.
5.6 Raportimi dhe vlerësimi.....	Error! Bookmark not defined.

1.HYRJE

Hartimi i këtij Plani është fryt i kontributit shumëpalësh të aktorëve të komunitetit të bashkisë, udhëhequr në këtë përpjekje nga Nënkryetarja e Bashkisë Tepelenë, Znj. Julinda Karteri. Analizimi i situatës dhe përcaktimi i piketave për të ardhmen është ndërmarrë me kontributin e veçantë të Drejtorive të Bashkisë përgjatë takimeve periodike të grupit të punës.

Kontribut të vyer kanë ofruar përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucionet që ushtrojnë veprimtari në territorin e bashkisë me sugjerime gjatë takimeve të hapura konsultuese.

2.KONTEKSTI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE (MIM)

2.1 Vëzhgim i përgjithshëm mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve

Aspirata e Shqipërisë për t'u integruar në Bashkimin European, e konkretizuar përmes Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duhet të mbështetet nga një zhvillim i qëndrueshëm mjedisor. Për këtë qëllim janë përcaktuar një sërë objektivash, përmbushja e të cilëve monitorohet dhe vlerësohet çdo vit në raportet vjetore të BE-së për Shqipërinë, përkatësisht në Kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.

BE në 2025 vëren se Shqipëria ka një nivel vetëm pjesërisht të përputhur me *acquis* të BE-së në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe kërkon përpjekje për përmirësimin e sistemit ekzistues. Cilësohet veçanërisht vlerësimi i ndikimit mjedisor të gjenerimit dhe trajtimit të mbetjeve dhe forcimi i zbatimit të legjislacionit.

Shqipëria aktualisht ka përputhje të pjesshme me: Direktivën Kuadër për Mbetjet, Direktivën për Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Rregulloren e Paketimit dhe Mbetjeve të Paketimit, *Acquis* për plastikat njëpërdorimshme, si dhe me legjislacionin e ri për Dërgesat e Mbetjeve dhe Bateritë, përditësuar me kërkesa më të rrepta.

Gjithashtu, BE inkurajon më shumë përfshirje të ekonomisë qarkulluese, duke parë jo vetëm trajtimin e mbetjeve, por gjithë ciklin e jetës së produkteve. Brenda vitit 2025 Shqipëria është angazhuar të miratojë përveç ligjit të ri për menaxhimin e mbetjeve, edhe ligjin për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit.

Disa periudha tranzitore deri në vitin 2036 janë kërkuar tashmë për riciklimin, mbetjet bio dhe përgatitjen për ripërdorim, zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe devijimin nga landfilli. Këto kërkesa për shtyrje të afatit të përmbushjes së objektivave mbeten për t'u shqyrtuar nga BE pas marrjes së informacioneve shtesë mbi: gjendjen aktuale të infrastrukturës dhe mbledhjes së mbetjeve, kufizimet financiare dhe teknike, investimet e nevojshme për riciklim, rikuperim dhe devijim nga landfilli, kapacitetet e riciklimit dhe kostot e eksportit, planet për kompostimin e mbetjeve të gjelbra dhe riciklimin e mbetjeve ushqimore, masat për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.

Në këtë kuadër vendi duhet të paraqesë edhe afatet kohore të qarta për përputhjen e plotë me *acquis* të BE-së.

Gjenerimi i mbetjeve bashkiake të vendit është i krahasueshëm me ekonominë fqinje në rajon, raportuar në rënie nga 1.4 milion ton në 2015 (491 kg për frymë) në 0.9 milion ton në 2023 (348 kg për frymë). Ky reduktim mund të reflektojë raportim të përmirësuar dhe jo një tendencë të qëndrueshme rënëse. Në vitin 2022, mbetjet organike përbënin 58.1% të mbetjeve bashkiake, ndërsa plastika dhe letra përkatësisht 9.2% dhe 8.9%.

Ndërkohë që 89% e popullsisë ka akses në grumbullimin e mbetjeve, kryesisht në zonat urbane, Shqipëria mbështetet shumë në depozitim të mbetjeve në landfill (mbi 70% të mbetjeve), në kontrast me vendet e BE-së ku sasia e mbetjeve të asgjësuara në landfille është 23%. Sasi të konsiderueshme të mbetjeve të krijuara nuk depozitohen në objektet e kontrolluara të asgjësimit, që rezulton në ndotje të natyrës, lumenjve, liqeneve, detit dhe mjedisit në përgjithësi.

2.2 Korniza ligjore dhe e politikave

Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nenit nr. 108, "Mjedisi", Shqipëria është angazhuar të zhvillojë dhe të forcojë bashkëpunimin me BE në luftën kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

Pozicioni negociues i Shqipërisë i shpalosur në Nëntor 2025, është i orientuar drejt përmbylljes së negociatave të pranimit deri në vitin 2027 dhe arritjen e anëtarësimit deri në vitin 2030. Shqipëria ka hapur të gjashtë grup-kapitujt negociues, me të fundit mbi burimet, bujqësinë dhe kohezionin. Në këtë proces Kapitulli 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, ku përfshihen objektivat në fushën e ekonomisë qarkulluese dhe menaxhimit të mbetjeve, është ndër kapitujt më kompleks të negociatave. Hapi i radhës, vendimtar, është përmbushja e standardeve të ndërmjetme dhe mbyllja e kapitujve, të cilat do të kërkojnë zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të legjislacionit të BE-së. Ky hap përfshin dhe udhërrëfyesit e zbatimit të politikës specifike të BE-së për menaxhimin e mbetjeve, sipas afateve kohore të dakordësuara mes BE-së dhe Shqipërisë.

Ministria përgjegjëse për mjedisin, për të drejtuar politikën shtetërore në fushën e menaxhimit të mbetjeve, harton Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin e veprimit, si dhe Planin Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve.

2.2.1 Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 është hartuar nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 418 datë 27.05.2020. Objektivat specifike të strategjisë janë të ofrojë zgjidhje praktike në:

- trajtimin e problemeve të deritanishme të sistemit të menaxhimit;
- zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi;
- përmbushjen e detyrimeve specifike të legjislacionit të KE për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë objektivat ambiciozë të paketës për ekonominë qarkulluese.

Pesë qëllimet strategjike përqendrohen në:

1. Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit;
2. Përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;
3. Financimin e qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve;
4. Burimet njerëzore, rritjen e ndërgjegjësisë dhe pjesëmarrjen e popullatës në menaxhimin e mbetjeve;
5. Instrumentat ligjorë, institucionalë dhe financiarë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Strategjia Kombëtare e MIM i parashikon sistemet e MIMN në bazë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve: "Një Zonë e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM) është një territor që mbulon juridiksionin e një ose më shumë bashkive që kanë një tipologji gjeografike të ngjashme dhe ofron një komunikim të pandërprerë të rrjetit rrugor, gjë e cila lehtëson grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve drejt destinacioneve për para-trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin përfundimtar."

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Në Strategji përcaktohen këto standarde minimale dhe veprimtari me prioritet që lidhen me rrymën e mbetjeve bashkiake:

1. 100% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat urbane (Prioriteti 1)
2. Mbetjet të depozitohen në një vend depozitim të autorizuar dhe të kontrolluar (Prioriteti 1)
3. 90% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale (Prioriteti 2)
4. Ndarja e mbetjeve për të vijuar më tej me riciklimin (Prioriteti 3)

Gjithashtu strategjia përcakton synimet për zbatimin e praktikave të përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve. Disa objektiva të përzgjedhura janë si vijon:

Objektiva (të përzgjedhura) Plani Kombëtar i MIM 2020	2025	2030	2035
Mbulimi me shërbim grumbullimi (i popullsisë)	80%	90%	95%
Niveli i grumbullimit (i mbetjeve të gjeneruara)	70%	90%	95%
Mbulimi me shërbim të MIM (total) (në zonat urbane >100,000 banorë)	30% 35%	60% 70%	80% 100%
% e sasisë së mbetjeve (për çdo fraksion) që shkojnë për riciklim / sasia totale e mbetjeve që gjenerohet	20%	30%	40%
Sasia e reduktuar e mbetjeve të biodegradueshme (krahasuar me 2016)	75%	55%	35%
% e sasisë së mbetjeve depozituara në landfill ose vendgrumbullim / sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara	50%	30%	10%
Rehabilitimi dhe mbyllja e venddepozitimeve		1	1

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në direktivën kuadër të menaxhimit të mbetjeve 2008/98/EC, që është transpozuar në kuadrin ligjor shqiptar, janë:

1. *Hierarkia e mbetjeve*—parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve, sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve, duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.
2. *Ndotësi paguan*—lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen tek ndotësit dhe tek konsumatorët përgjegjës për të.

3. *Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit*—është përgjegjësia që duhet të ketë një prodhues apo importues gjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve, që prej krijimit deri në shkallën e postkonsumit. Përparësi i duhet dhënë ndarjes së diferencuar të produkteve dhe të materialeve që paraqesin një rrezik më të lartë ndaj mjedisit dhe/ose për ato produkte që ka treg përpunimi për qëllime riciklimi ose rikuperimi.
4. *Parandalimi i rrezikut mjedisor*—nënkupton që kur ka të dhëna mbi praninë e rrezikut mjedisor, duhen marrë masa të përshtatshme parandaluese.
5. *Integrimi*—mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit të politikave.
6. *Përgjegjësia e ndërsjellë*—të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e Strategjisë.
7. *Parimi i vetëmjaftueshmërisë*—nënkupton që vendi të zhvillojë një rrjet pajisjesh dhe impiantesh të integruara dhe të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve.
8. *Parimi i afërsisë*—mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve.
9. *Përballueshmëria financiare*—niveli i tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë i përballueshëm dhe i pranuar nga komuniteti.
10. *E drejta për informim dhe pjesëmarrje*—çdo qytetar ka të drejtë të marrë informacion rreth menaxhimit të mbetjeve lehtësisht nga të gjitha institucionet përgjegjëse. E drejta për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje nënkupton që publiku duhet të jetë i informuar për të gjitha projektet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe duhet t'i jepet mundësia të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
11. *Zbatimi i praktikave më të mira*—për të eliminuar mangësitë, për të siguruar kontrollin dhe zbatimin e standardeve evropiane.

2.2.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032, i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1 datë 13.01.2020, është një instrument planifikues i nivelit të dytë për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Meqë disa elementë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë në mënyrë që funksionimi të kryhet me efikasitet kostoje dhe shumica e bashkive në Shqipëri janë të vogla për të siguruar funksionimin efikas të impianteve të mëdha, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive, përkatësisht procesi i ashtuquajtur "rajonalizim" ose ndarja në Zona të Menaxhimit të Mbetjeve. Plani Sektorial përcakton kufijtë e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe paraqet kuadrin e planifikimit për investime në infrastrukturën e MMN në secilën ZMM. Plani Sektorial ka këto objektiva specifike:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin e MMN,
- të përcaktojë kostot përkatëse dhe nivelet e tarifave në të ardhmen,

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

- të mundësojë një sistem objektiv, të verifikueshëm dhe transparent për caktimin e prioriteteve për investime në infrastrukturën e MIMN,
- të paraqesë një plan investimesh për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN, të ndarë në faza afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, që të sigurojë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin, si dhe impiantet e trajtimit dhe/ose depozitimit të mbetjeve,
- të propozojë ndryshime të nevojshme ligjore dhe institucionale,
- të propozojë masa të tjera shoqëruese.

Plani Sektorial dhe Ligji i 2025 i menaxhimit të integruar të mbetjeve, e ndan territorin e vendit në 10 Zona të Menaxhimit të Mbetjeve. Njëra prej tyre është Zona e Mbetjeve Vlorë Jug—Gjirokastrë, e cila përfshin territorin e Bashkisë Tepelenë.

2.2.3 Legjislacioni kombëtar për mbetjet

Kuadri ligjor dhe rregullator shqiptar me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbetjeve përmbledhet në paragrafët në vijim.

Veçojmë faktin që gjatë përpilimit të këtij plani vendor, janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë Ligji Nr. 57/2025 datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe Ligji Nr. 74/2025 datë 04.12.2025 "Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetjeve", si edhe Vendimi Nr. 286 datë 17.04.2026 nga Këshilli i Ministrave "Për miratimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve". Ligji për MIM synon përafrimin me aquis të BE-së dhe progresin drejt ekonomisë qarkulluese me objektiva për përmirësim të shëndetit publik dhe mjedisit, progres në reduktimin e sasisë së mbetjeve të gjeneruara, rritje të shkallës së riciklimit, reduktimin e sasisë së mbetjeve për asgjësim në landfille. Ky ligj themeltar i menaxhimit të mbetjeve rikonfirmon rolin dhe kompetencën e bashkive si përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake dhe rrymave të përcaktuara në ligj, në territorin bashkiak përmes sistemit të grumbullimit të mbetjeve.

Ligji i posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit ka si qëllim ngritjen dhe funksionimin e skemës për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesit (PZP), në mënyrë që çdo person fizik ose juridik që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale, produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit. Sistemet e riciklimit për ambalazhet dhe mbetjet e tjera specifike janë përgjegjësi e prodhuesve dhe industrisë së riciklimit, të cilët duhet t'i organizojnë nën skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP), duke siguruar që mbetjet e krijuara nga produktet e tyre të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.

Ligje

- "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Ligji nr. 57, datë 16.10.2025)
- "Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetjeve" (Ligji nr. 74, datë 04.12.2025)

Aktet nënligjore (VKM)

- "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 575, datë 24.6.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" (VKM nr. 338 datë 19.06.2025)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, "Për miratimin e rregullave për Eksportin e mbetjeve dhe Kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte", të ndryshuar (VKM nr. 520, datë 1.8.2024)
- "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve" (VKM nr. 132, datë 6.3.2024), amenduar
- "Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" (VKM nr. 418, datë 27.5.2020)
- "Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta" (Vendim nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 13.01.2020)
- "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve" (VKM nr. 319, datë 31.05.2018)
- "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve" (VKM nr. 431, datë 11.07.2018)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave "Për lëndfillet"" (VKM nr. 389, datë 27.6.2018)
- "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të vend depozitimeve të mbetjeve" (VKM nr. 428 datë 8.6.2016)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 641 datë 1.10.2014 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte" (VKM Nr. 94 datë 14.2.2018)
- "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve" (VKM nr. 687, datë 29.07.2015)
- "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" (VKM nr. 575, datë 24.06.2015)
- "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre" (VKM nr. 608, datë 17.9.2014)
- "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura" (VKM nr. 387, datë 06.05.2015)
- "Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve dhe modelin e autorizimit për kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte" (Urdhër nr. 1957 datë 6.11.2014)
- "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte" (VKM nr. 641, datë 01.10.2014)

- "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" (VKM nr. 418, datë 25.06.2014)
- "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" (VKM nr. 371, datë 11.06.2014)
- "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme" (VKM nr. 229, datë 23.04.2014)
- "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 117 datë 13.02.2013 të Këshillit të Ministrave "Për Kriteret që përcaktojnë kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje" (VKM nr. 52, datë 05.02.2014)
- "Për miratimin e modelit të regjistrave për operatorët që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura" (Urdhër nr. 893 i vitit 2013)
- "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje" (VKM nr. 117, datë 13.02.2013)
- "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike" (VKM nr. 957, datë 19.12.2012)
- "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre" (VKM nr. 866, datë 04.12.2012)
- "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura" (VKM nr. 765, datë 07.11.2012)
- "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës" (VKM nr. 705, datë 10.10.2012)
- "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 825 datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për përdorim, përpunim dhe riciklim" (VKM nr. 550, datë 22.08.2012)
- "Për landfill-et e mbetjeve" (VKM nr. 452, datë 11.07.2012)
- "Për incinerimin e mbetjeve" (VKM nr. 178, datë 06.03.2012)
- "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre" (VKM nr. 177, datë 06.03.2012, ndryshuar ne VKM nr.232 datë 26.04.2018)
- "Për heqjen e mjeteve motorike, të rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare" (Akt normativ nr. 3, datë 07.09.2011)
- "Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane" (VKM nr. 333, datë 26.01.2011)
- "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"" (VKM nr. 798, datë 29.09.2010)
- "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" (VKM nr. 1189, datë 18.11.2009)
- "Për miratimin e Katalogut të mbetjeve" (VKM nr. 402, datë 30.06.2021)

- Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve” (VKM nr.660, datë 31.10.2018)
- “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura” (VKM 652, datë 14.09.2019)

Udhëzime

- “Për kriteret e studimit të projekteve për mbylljen dhe rindërtimin e vend depozitimeve për mbetjet e ngurta urbane” (Udhëzim nr. 1250, datë 23.02.2009 dhe nr. 406/1, datë 03.03.2009, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta” (Udhëzim nr. 6, datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave)

Rregullore

- “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre” (Rregullore nr. 1, datë 30.03.2007, e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Rregullore higjieno-sanitare për pastrimin në zonat urbane dhe rurale, për administrimin dhe trajtimin e mbeturinave” (Rregullore nr. 376, datë 17.11.1997, e Ministrisë së Shëndetësisë)
- “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullore nr.6, datë 30.11.2007, VKM nr.798, datë 29.09.2010)

Ligje që lidhen me mbrojtjen mjedisore:

- “Për mbrojtjen e mjedisit” (Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011)
- “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011)
- “Për lejet e mjedisit” (Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011)
- “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448 datë 14.7.2011, Për lejet e mjedisit” (Ligji nr. 44, datë 14.02.2013)
- Ligje të tjera që plotësojnë kuadrin lidhur me zbatimin e shërbimeve në fushën e menaxhimit të mbetjeve:
- “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017)
- “Për vetëqeverisjen vendore” (Ligji nr. 139, datë 17.12.2015)
- “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 115, datë 31.07.2014)
- “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (Ligji nr. 107, datë 31.07.2014, i amenduar me Ligjin nr. 73 datë 09.07.2015)

- "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" (Ligji nr. 125, datë 25.04.2013, i amenduar me Ligjin Nr.88/2014, Ligjin nr. 77 datë 16.07.2015, Ligjin Nr. 50, datë 18.07.2019)
- "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" (Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011)
- "Për planifikimin e territorit" (Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009)
- "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, i amenduar me Ligjin nr. 129 datë 02.10.2014)
- "Për ankandin publik" (Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008)
- "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001, i amenduar 2006, 2007)
- "Për pronat e paluajtshme të shtetit" (Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001, i amenduar 2006)

2.3 Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor

2.3.1 Niveli kombëtar

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri ndahen midis nivelit kombëtar, rajonal apo zonal dhe atij vendor. Këto përgjegjësi funksionale janë përcaktuar në dokumentet kyç, pra në Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

Në nivel qendror, autoritetet përgjegjëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të cilat ushtrojnë kryesisht funksione politikëbërëse, rregullatore monitoruese dhe zbatuese janë: Ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit.

Ministria e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përcaktimin e objektivave kombëtare për reduktimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve, si dhe për përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike përkatëse, duke përfshirë Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Ajo siguron zbatimin e ligjit dhe koordinimin institucional ndërmjet autoriteteve qendrore e vendore, përcakton kriteret teknike për infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, mbikëqyr monitorimin dhe raportimin e të dhënave dhe miraton aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit në nivel vendi. Së bashku me institucionet e tjera vartëse, Ministria ka përgjegjësinë e plotë për krijimin dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal dhe vendor.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në varësi të MM, ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Në kuadër të menaxhimit të mbetjeve, AKM ka përgjegjësi për mbledhjen, administrimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore në nivel kombëtar, duke përfshirë treguesit që lidhen me menaxhimin e mbetjeve. AKM vë në dispozicion informacion të standardizuar për institucionet shtetërore dhe publikun, si bazë për vlerësimin e gjendjes mjedisore dhe për vendimmarrjen në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM), në varësi të MM, është krijuar me misionin që të sigurojë koordinimin, monitorimin dhe bashkëpunimin me qëllim kalimin e këtij sektori në ekonomi qarkulluese dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve në shkallë të gjerë. AKEM koordinon punën me institucionet në nivel qendror e vendor, partnerët ndërkombëtarë, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e standardeve në menaxhimin efikas të integruar të mbetjeve, planifikimin territorial në infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre. AKEM caktohet përmes ligjit të ri të menaxhimit të mbetjeve, si operator kombëtar i infrastrukturës rajonale (në nivel të zonës së mbetjeve) të menaxhimit të mbetjeve, me përgjegjësi për ndërtimin, administrimin dhe operimin e infrastrukturës kombëtare për trajtimin fundor të mbetjeve. AKEM—sipas dispozitave të ligjit të ri, është pjesë e marrëveshjeve ndërbashkiake dhe garanton standardet kombëtare për riciklim, ripërdorim dhe trajtim.

Kuadri ligjor, ngarkon ministritë e tjera si ministrinë përgjegjëse për financat, ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për hartimin e akteve nënligjore specifike sipas përgjegjësive që kanë në fushën e mbetjeve.

2.3.2 Niveli rajonal

Këshilli i Qarkut është niveli i dytë i qeverisjes vendore në Shqipëri dhe nuk është drejtpërdrejt përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, megjithatë neni 13, Ligji nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, e ngarkon me hartimin dhe miratimin e planit rajonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe raportimin tek MM çdo vit mbi zbatimin e tij.

Ligji i 2025 i MIM artikulon Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve, si niveli rajonal / zonal, përcaktuar sipas miratimit të Këshillit Kombëtar të Territorit, brenda të cilit kryhen operacione në nivel ndërvendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve nga aspekti territorial përfshijnë një ose më shumë bashki që duhet të bashkëpunojnë për organizimin dhe investimet në trajtimin e mbetjeve bashkiake.

Si pjesë e Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve, ligji parashikon që bashkitë të nënshkruajnë marrëveshje me AKEM dhe bashki të tjera të Zonës së Mbetjeve për infrastrukturën rajonale të MM dhe financimin e përbashkët. Kjo strukturë ndërvendore e zonës monitoron zbatimin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të ZMM dhe raporton çdo vit mbi progresin në arritjen e objektivave dhe zbatimin e masave të parashikuara.

Bashkitë që bëjnë pjesë në të njëjtën zonë kanë përgjegjësi të përbashkëta për menaxhimin e mbetjeve dhe marrëveshjet ndërbashkiake përcaktojnë organizimin, rolet, detyrimet dhe financimin e përbashkët të infrastrukturave të nevojshme të ZMM-së.

2.3.3 Niveli vendor

Roli i bashkive në menaxhimin e mbetjeve është përcaktuar nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili u njeh atyre përgjegjësinë për organizimin, mbledhjen dhe transportin e mbetjeve deri në pikat e grumbullimit. Bashkitë kanë gjithashtu të drejtën të krijojnë dhe të operojnë qendra për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e riciklueshme, të biodegradueshme dhe ato të vëllimshme. Këto njësi vendore përcaktojnë mënyrën e ofrimit të shërbimit sipas kushteve lokale, si dhe mund të bashkëpunojnë me bashki të tjera për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të përbashkëta të trajtimit të mbetjeve.

Ligji 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, së bashku me aktet nënligjore përkatëse përcaktojnë detyrat e detajuara të bashkive në këtë fushë, përfshirë planifikimin dhe raportimin e veprimtarive të menaxhimit të mbetjeve në juridiksionin e tyre.

Shërbimet mund të kryhen përmes strukturave bashkiake, ndërmarrjeve publike në varësi të bashkisë apo përmes kontratës me sektorin privat. Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, rikonfirmon rolin dhe kompetencën e bashkive si përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake dhe rrymave të përcaktuara në ligj, në territorin bashkiak. Sistemi i menaxhimit të mbetjeve duhet të synojë mbulimin e të gjithë territorit me shërbim, të garantojë grumbullim të diferencuar sipas rrymave përkatëse dhe të përcaktojë në përgjithësi vendndodhjen e infrastrukturës së nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve brenda territorit të bashkisë. Sistemi bashkiak i menaxhimit të mbetjeve koordinohet edhe me subjektet prodhuese që zbatojnë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe kanë të drejtë të investojnë dhe të ndërtojnë sistemet e tyre për grumbullimin, transportin dhe trajtimin final të rrymave të mbetjeve.

Bashkitë janë ngarkuar të organizojnë fushata informuese dhe ndërgjegjësuere të komunitetit, por ndërkohë të monitorojnë territorin për mbetje të hedhura në mënyrë të paligjshme dhe të bashkëpunojnë me institucionet qendrore për masa ndëshkimore. Bashkitë mbledhin dhe raportojnë statistika vjetore të mbetjeve dhe i dorëzojnë të dhënat tek AKEM dhe AKM.

Instrumenti kryesor planifikues në nivel bashkiak është Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, përfshirë dhe plane për rryma të veçanta të mbetjeve (letër, karton, qelq, plastikë, metal, bio). Plani, i cili duhet të jetë në përputhje me planet kombëtare dhe zonale, miratohet nga Këshilli Bashkiak pas miratimit teknik nga AKEM dhe përditësohet të paktën çdo 5 vjet.

3.KONTEKSTI VENDOR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

3.1 Profili zhvillimor i Bashkisë

3.1.1 Pozita gjeografike e Bashkisë

Bashkia Tepelenë shtrihet në jug të vendit dhe kufizohet: në veri me Bashkinë Memaliaj, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Gjirokastrë dhe në perëndim me Bashkitë Himarë dhe Selenicë. Qendra administrative e bashkisë është qyteti i Tepelenës. Brenda territorit të saj përfshihen katër njësi administrative:

Njësitë administrative	Qytetet dhe fshatrat
Tepelenë	Qyteti i Tepelenës
Kurvelesh	5 Fshatra: Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin
Lopës	5 Fshatra: Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmban, Lab Martalloz
Qendër Tepelenë	14 Fshatra: Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat.

Bashkia Tepelenë shtrihet në një sipërfaqe prej 431,24 km². Terreni karakterizohet nga një reliev me kontraste të theksuara morfologjike. Brenda kësaj hapësire shtrihen zona kodrinore dhe kodra mesatare, male me shpate të pjerrëta, si edhe lugina lumore me forma të ndryshme. Pjesa më e madhe e territorit ka një reliev kryesisht malor me formacione gjeologjike mbizotëruese me përmbajtje gëlqerore. Pika më e lartë e masivit malor në perëndim të lumit Vjosë është mali i Këndrevicës, me lartësi 2121 metra. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 732 metra.

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Territori i Bashkisë Tepelenë bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare malore, e karakterizuar nga dimër i ftohtë me reshje dhe verë e ngrohtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore është rreth 14°C dhe reshjet mesatare variojnë nga 1,200 mm deri në 1,600 mm. Pozicioni gjeografik, relievi dhe veçoritë specifike të territorit krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e habitateve natyrore të shumëllojshme dhe ekosistemeve malore komplekse, të cilat mbështesin një biodiversitet të pasur bimor. Karakteristikat klimatike dhe morfologjike të Bashkisë Tepelenë ndikojnë drejtpërdrejt edhe në organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Temperaturat e larta gjatë sezonit veror, reshjet intensive, terreni malor dhe rrjeti rrugor në disa zona rurale kërkojnë planifikim të kujdesshëm të itinerareve të grumbullimit, frekuencës së shërbimit dhe vendosjes së infrastrukturës së grumbullimit, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimit.

Resurset ujore sipërfaqësore në bashkinë Tepelenë janë kryesisht lumenjtë Vjosë, Drinos dhe lumi i Bënçës. Ndërsa, ujërat nëntokësore përfaqësohen nga burimet masive karstike si Uji i Ftohtë Tepelenë, Hormova, Lekel, Bença, Gurra në Progonat, Bambulli në Dukaj.

3.1.2 Zonat e mbrojtura

3.1.2.1 Parku Kombëtar i lumit Vjosa

Parku i lumit të Vjosës është një Park Kombëtar i kategorisë II sipas ligjit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës. Parku Kombëtar i lumit të Vjosës ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 12,727 ha, nga të cilat 47.3% sipërfaqe ujore dhe pjesa tjetër janë sipërfaqe bregore, fushë e ulët e përmytjeve aktive, sipërfaqe tokësore (breza lumorë, shpatet e kanioneve dhe rrëpirat e gërryeshme).




Figura 1 Harta e Parkut Kombëtar të lumit Vjosë

Parku Kombëtar i lumit Vjosë ndahet në dy nënzona:

a) Nënzona qendrore, me sipërfaqe 11,822 ha në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes (strikte), pasi performanca natyrore e saj është tepër e lartë, më pak ose aspak e shqetësuar nga veprimtaritë njerëzore. Ka përparësi ruajtjen tërësore të natyrës, të biodiversitetit, të llojeve të rrezikuara, monumentet e natyrës, të peizazhit unik tokësor, veçoritë natyrore të jashtëzakonshme gjeomorfologjike dhe historike pa qenë nevoja e ndërhyrjeve përmirësuese të përhershme, të cilat menaxhohen në atë mënyrë që të ruajnë gjendjen natyrore, të mbështesin lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor. Kjo nënzonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte dhe detajohet sipas përcaktimeve të bëra në planin e menaxhimit. Në këtë nënzonë lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë.

b) Nënzona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm me sipërfaqe 905 ha përfshin tokat pyjore, bujqësore e kullotat dhe territore ujore, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale, si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë ekonomike, që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror.

3.1.2.2 Parku Natyror i Zagorisë

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 26.1.2022 u miratua ndryshimi i sipërfaqes së ekosistemit natyror "Zagori", të shpallur "park natyror" (kategoria IV e zonave të mbrojtura). Kjo zonë përfshin sipërfaqe me pyje, tokë pyjore, bujqësore, shkurre, sipërfaqe ujore dhe zona urbane me sipërfaqe totale 24 607 ha, nga të cilat 2,979 ha i përkasin Bashkisë Tepelenë.




Figura 2 Harta e Parkut Natyror "Zagori"

Parku natyror i Zagorisë ndahet në dy nënzona ruajtjeje dhe administrimi:

- Nënzona Qëndrore përfshin habitatet kryesore pyjore, shkurre dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore.
- Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshin tokat pyjore, bujqësore dhe kullotat dhe territore ujore ku mundësohen vazhdimi i veprimtarive tradicionale si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike me përdorim të balancuar dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë ekonomike që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror.

3.1.2 Demografia

Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia ka një popullsi prej 6,761 banorësh dhe dendësi 15.7 banorë për km². Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 15,340 banorë.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet popullsia sipas njësive administrative sipas Census 2023 dhe sipas Regjistrit Civil 2021-2024.

Tabela 1 Popullsia për çdo Njësi Administrative sipas Census 2023 dhe Regjistrit të Gjendjes Civile

NJA	Census	Regjistri Civil			
	2023	2021	2022	2023	2024
Tepelenë	3,709	7,980	7,833	7,509	7,670

Kurvelesh	499	2,930	2,889	2,864	2,841
Lopës	517	1,861	1,849	1,824	1,808
Qendër Tepelenë	2,036	3,189	3,095	3,064	3,021
Totale	6,761	15,960	15,666	15,261	15,340
Urbane	3,700	7,980	7,833	7,509	7,670
Rurale	3,052	7,980	7,833	7,752	7,670

Më shumë se gjysma e popullsisë, rreth 54.7%, jeton në qytetin e Tepelenës. Njësia administrative me numrin më të vogël të banorëve është ajo e Kurveleshit. Njësitë e tjera (Lopës dhe Qendër Tepelenë) përbëjnë 37.8% të popullsisë së bashkisë.

Raporti gjinor sipas Censurit 2023 rezulton të jetë 51.5% meshkuj dhe 48.5% femra. Për sa i përket përbërjes sipas moshës, grupmosha 0–14 vjeç zë 12.5% të popullsisë totale, grupmosha aktive 15–64 vjeç përbën 62%, ndërsa popullsia mbi 65 vjeç arrin në 25.5%.

Popullsia e Tepelenës është ndikuar nga migrimi dhe ndryshimet sociale-ekonomike në Shqipëri. Sipas të dhënave, gjatë dekadave të fundit ka pasur një tendencë të migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, veçanërisht nga zonat rurale të rrethit drejt qyteteve më të mëdha dhe jashtë vendit. Kjo ka çuar në një ulje të popullsisë dhe një plakje të strukturës demografike në shumë fshatra.

3.1.3 Zhvillimi ekonomik

Ekonomia e Tepelenës mbështetet kryesisht në bujqësi dhe blegtori. Për shkak të terrenit malor, shumë zona nuk janë të përshtatshme për kultivimin e gjerë të tokës, por banorët kultivojnë kryesisht perime, drithëra dhe bimë mjekësore. Blegtoria është gjithashtu një burim kryesor të ardhurash, me rritjen e bagëtisë së imët (dele dhe dhi) që është pjesë tradicionale e jetesës rurale të rajonit.

Në territorin e Bashkisë Tepelenë, ka 20,524 hektarë kullota, 9,584 hektarë pyje dhe rreth 3,300 hektarë tokë bujqësore. Aktiviteti blegtoral përfaqëson një sektor të rëndësishëm ekonomik, me rreth 200 blegtorë që mbajnë afërsisht 40,000 krerë të imëta dhe 1,700 krerë të trasha. Po ashtu, në bashki operojnë 20 bletërritës me një total prej 2,368 kosheresh. Sektori i biznesit karakterizohet kryesisht nga njësi shërbimi dhe tregtare, të cilat janë të përqendruara kryesisht në zonën urbane. Këto struktura ekonomike dhe shpërndarja e tyre territoriale përbëjnë indikatorë të rëndësishëm për vlerësimin e prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor.

Nr	Biznese sipas aktivitetit	Totali	Sipas njësive administrative			
			Tepelenë	Kurvelesh	Lopës	Qendër Tepelenë
A	Institucionet shtetërore	15	15	0	0	0
B	Shoqata Jo-fitimprurëse			0	0	0

C	Biznese	508	423	22	6	57
1	Njësi tregtare dhe shërbimi	431	366	22	5	38
2	Njësi tregtare për tregtim karburanti	5	4	0	0	1
3	Njësi prodhimi	7	7	0		0
4	Subjekte ndërtimi	24	19	0	1	4
5	Profesione të lira	27	27	0	0	0
6	Tregëtar ambulant	14	0	0	0	14

Tabela: Bizneset sipas aktivitetit dhe Njësive Administrative

Sektori i turizmit ka filluar të zhvillohet më shumë vitet e fundit, duke tërhequr vizitorë që kërkojnë të eksplorojnë natyrën e paprekur të rajonit, kulturën dhe trashëgiminë historike. Kalaja e Tepelenës, vendet natyrore si kanionet e Nivicës dhe lumenjtë e pastër të Vjosës janë atraksione të rëndësishme për turistët. Vitet e fundit janë shtuar hotelet, bujtinat për shkak të shtimit të numrit të turistëve në zonë. Në territorin e bashkisë operojnë 15 subjekte akomoduese (bujtina), nga të cilat 8 janë në njësinë administrative Kurvelesh, 6 në njësinë administrative Qendër dhe 1 në njësinë administrative Lopës.

Viti 2025					
NJA	Familje gjithsej (nr)	Familje me ndihmë ekonomike (nr)	% ndaj totalit	Familje që kanë persona me aftësi ndryshe (nr)	% ndaj totalit
Tepelenë	3,002	65	2.17%	180	6.00%
Kurvelesh	720	16	2.22%	23	3.19%
Lopës	598	15	2.51%	17	2.84%
Qendër Tepelenë	1,265	111	8.77%	153	12.09%
Totali	5,585	207	3.71%	373	6.68%

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se 207 familje përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Tepelenë, ku 65 prej tyre janë në qytetin e Tepelenës. Në raport me numrin total të familjeve, rezultojnë se përfitojnë ndihmë ekonomike 3.71% e familjeve. Familjet me persona me aftësi ndryshe janë 373 në total dhe përbëjnë 6.68% të totalit të familjeve.


3.2.Sistemi dhe praktikat aktuale të menaxhimit të mbetjeve

3.2.1 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki

Ushtrimin e funksionit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në planifikim, financim, zbatim dhe monitorim, bashkia e përmbush përmes strukturave të saj, ku përfshihet Drejtoria e Shërbimeve Publike që është drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve.

Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit ofrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e cila ka gjithsej 72 punonjës, ndërsa për menaxhimin e mbetjeve bashkia në total ka 24 punonjës. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane sigurohet nga 1 mbikëqyrës, 12 punëtorë pastrimi me kohë të plotë, 2 punëtorë me kohë të pjesshme dhe 2 shoferë mjetesh.

Figura: Organograma e Bashkisë Tepelenë për vitin 2024



3.2.2 Prodhimi dhe përbërja e mbetjeve

Të dhënat e Bashkisë Tepelenë mbi prodhimin e mbetjeve mbeten të bazuara kryesisht në vlerësime orientuese, pasi matja e saktë nuk kryhet për shkak të mungesës të një peshoreje në pikën e depozitimit. Vlerësimet realizohen duke u mbështetur në numrin e popullsisë dhe në kapacitetin e kontenerëve që boshatisen çdo ditë nga mjetet teknologjike. Sipas përlllogaritjeve të kryera nga stafi teknik, në periudhën dimërore mblidhen rreth 4–5 ton mbetje në ditë, ndërsa gjatë sezonit veror kjo sasi arrin në 7–8 ton në ditë për shkak të rritjes së numrit të popullsisë dhe aktivitetit ekonomik. Në bazë të këtyre vlerësimeve, sasia mesatare vjetore e mbetjeve të grumbulluara dhe transportuara rezulton rreth 3,090 ton në vit.

Tabela 2 Të dhëna për numrin e popullsisë dhe sasi të mbetjeve, viti 2025

Viti 2025 (sipas shërbimit që ofrohet)			
NJA	Numri i banorëve	Mbetje që grumbullohen mesatarisht (t/ditë)	Mbetje që grumbullohen mesatarisht (t/vit)
Tepelenë	7,500	4	1,460
Kurvelesh	2,500	1.25	450
Lopës	1,000	0.5	180
Qendër Tepelenë	4,000	2.75	1,000
Total	15,000	8.5	3,090

3.2.2.1 Përbërja e mbetjeve

Bashkia Tepelenë ka qenë pjesë e një programi të Mbështetjes Teknike për sistemin e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, i cili u zbatua në dy qarqe të përzgjedhura në Shqipëri. Studimi, i përfunduar në vitin 2019, përfshinte analizën e mostrave për




Figura 3 Përbërja e mbetjeve

merceologjinë e mbetjeve. Analizat mbulojnë sezonin dimëror: fillimin e janarit 2018 deri në mes të marsit 2018. Për qarkun Gjirokastrë u morën gjithsej 8 mostra, nga të cilat njëra u mor në Bashkinë Tepelenë. Rezultatet e studimit konfirmuan uniformitetin e përbërjes merceologjike në këtë zonë. Pas konsultimeve me grupin e punës, u ra dakord që përbërja merceologjike e paraqitur në këtë

grafik është e aplikueshme për Bashkinë Tepelenë.

Të dhënat në grafikun e mësipërm tregojnë se fraksionet organike janë pjesa më e madhe e mbetjeve të prodhuara 61%. Letra dhe kartoni, plastika dhe mbetjet e tjera janë fraksionet e tjera më të mëdha me një përbërje prej 12%. Qelqi dhe metal-alumini janë fraksionet më të vogla me përqindje respektivisht 2% dhe 1%.

3.2.3 Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve (kontenierët, itineraret)

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Tepelenë është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit, duke siguruar mbulim të plotë në zonën urbane dhe rreth 90% mbulim në zonat rurale. Ky progres lidhet kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës rrugore në territoret që më parë nuk ishin të aksesueshme. Aktualisht, bashkia ofron shërbim pastrimi dhe grumbullimi në 88% të territorit. Përgjatë bënë disa zona të thella rurale, si Mezhgorani i Sipërm (ku shërbimi ofrohet vetëm pjesërisht), si edhe fshatrat Dorëz, Dukaj dhe Lekël, të cilat mbeten të pamunduara për t'u mbuluar për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe terrenit të vështirë.



Figura 4 Kamioni kompaktor i grumbullimit të mbetjeve në qytet

Për shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve përdoret makinë teknologjike 10 t, për zonën urbane dhe kamion 5 t, për zonën rurale dhe zonat ku është e pamundur të përdoret makina teknologjike 10 t.

Mjeti teknologjik 5 ton punon 6 ditë në javë sipas grafikut të miratuar, nga ku çdo fshat apo njësi administrative pastrohet në ditën e caktuar në grafik. Mjeti qarkullon lehtësisht në rrugicat e fshatrave dhe rrugët e ngushta, por është në gjendje të keqe teknike dhe ka nevojë të vazhdueshme për mirëmbajtje.

1. Njësia Administrative Tepelenë përfshin qytetin e Tepelenës, lagjet Gurëz, Demokracia, Fermë dhe Majkosh, si edhe zonën e Ujit të Ftohtë dhe segmentin e Rrugës Nacionale Tepelenë–Mamaj. Në këtë territor janë të vendosur gjithsej 98

kontenierë me kapacitet 1.6 m³. Zona mbulohet 100% me shërbim pastrimi dhe grumbullimi, ndërsa mjeti i dedikuar kryen shërbimin gjashtë ditë në javë.

2. Në Njësinë Administrative Qendër Tepelenë, terreni është kryesisht kodrinor dhe malor, por infrastruktura rrugore është në gjendje të mirë dhe mundëson ofrimin e shërbimit. Mbulimi i grumbullimit të mbetjeve arrin rreth 85%, me përjashtim të fshatit Lekël dhe fshatit Mezhgoran, ku shërbimi ofrohet vetëm pjesërisht për shkak të mungesës së infrastrukturës. Në këtë njësi janë të vendosur gjithsej 106 kontenierë me kapacitet 1.1 m³. Shërbimi kryhet sipas grafikut, katër ditë në javë.
3. Në njësinë administrative Kurvelesh relievi është kryesisht malor, por infrastruktura mbetet e aksesueshme. Shërbimi i grumbullimit ofrohet 100 %, duke mbuluar të gjitha fshatrat dhe akset rrugore të njesisë. Shërbimi kryhet dy ditë në javë sipas grafikut të miratuar. Në këtë territor janë vendosur gjithsej 38 kontenierë me kapacitet 1.1 m³.
4. Në njësinë administrative Lopës ofrohet shërbimi 90%, mungon në fshatin Dorëz (në të cilin banon vetëm 1 familje që mirëmban Vendin e Shenjtë) për shkak të mungesës së infrastrukturës. Shërbimi ofrohet 1 ditë në javë. Në këtë njësi administrative janë stacionuar 14 kontenierë 1.1 m³.

Bashkia Tepelenë e kryen shërbimin e pastrimit nëpërmjet 2 skuadrave të pastrimit. Skuadra e njesisë administrative Tepelenë përbëhet nga 1 shofer dhe 2 punonjës dhe punon 6 ditë në javë. Kjo skuadër vepron sipas grafikut të mëposhtëm dhe përdor mjetin me kapacitet 10 ton.

Tabela 3 Grafiku i punës i skuadrës 1 për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve

Dita	Rruga	Numri i kontenierëve
E hënë	Qytet – L.Gurëz – L.Demokracia – Uji i Ftohtë – Stabilimenti	51 kontenierë
E martë	Qytet – L. Gurëz – L. Demokracia – Uji i Ftohtë – IEVP Bëncë – Veliqot	64 kontenierë
E mërkurë	Qytet – L. Gurëz – L. Demokracia – Uji i Ftohtë – Aksi Mezhgoran – Ura e Leklit	62 kontenierë
E enjte	Qytet – L. Gurëz – L. Demokracia – Uji i Ftohtë	67 kontenierë
E premte	Qytet – L. Gurëz – L. Demokracia – Uji i Ftohtë – Luzat – Bëncë – Stabilimenti	55 kontenierë
E shtunë	Qytet – L. Gurëz – L. Demokracia – Uji i Ftohtë – Aksi Mezhgoran – Ura e Leklit	62 kontenierë

Skuadra tjetër mbulon njësitë administrative Qendër, Kurvelesh dhe Lopës dhe përbëhet nga një shofer dhe 1 punonjës.

Skuadra përdor mjetin me kapacitet 5 ton dhe punon 5 ditë në javë sipas grafikut:

Tabela 4 Grafiku i punës i skuadrës 2 për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve

Dita	Rruga 1	Rruga 2	Numri i kontenierëve
E hënë	Nivicë – Gusmar	Qytet – Mamaj	29 kontenierë
E martë	Progonat – Lekdush	Dukaj	32 kontenierë
E mërkurë	NjA Lopës – Salari	Turan – Rr. Dukaj – Smt	36 kontenierë
E enjte	Hormovë – Subash	Kodër – Dragot	24 kontenierë
E premte	Peshtan	Beçisht – Luzat	17 kontenierë

Grafikët janë përcaktuar nga bashkia me qëllim rritjen e performancës dhe uljen e kostove ekonomike dhe kohore pas ndryshimeve të viteve të fundit të rrugëve të brendshme të fshatrave në të gjitha njësitë administrative duke përmirësuar aksesueshmërinë dhe shtrirjen e shërbimit.




Figura 5 Harta digjitale e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Tepelenë

Sistemi aktual duhet të vlerësohet edhe nga këndvështrimi i aftësisë për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike. Fenomenet ekstreme klimatike, si reshjet intensive, përmytjet lokale apo temperaturat e larta, mund të ndikojnë në funksionimin e shërbimit, duke rritur kostot operative, vështirësuar aksesin në disa zona dhe shtuar rrezikun e ndotjes së mjedisit nga mbetjet e paadministruara.




Figura 6 Harta digjitale e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve në zonën urbane

3.2.4 Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve

Shërbimi i pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve organizohet dhe administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve, duke u ofruar 6 ditë në javë, në përputhje me planin operacional të miratuar nga Bashkia.

Aktualisht, shërbimi siguron mbulim 100% në zonën urbane të territorit administrativ të Bashkisë. Në zonat rurale, niveli i mbulimit arrin rreth 90%, ndërsa një pjesë e kufizuar e fshatrave, konkretisht Dorëz, Mezhgoran dhe Matohasanaj, nuk përfshihen ende në skemën e shërbimit për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore dhe aksesit të përshtatshëm për mjetet e pastrimit.

Numri i punonjësve të angazhuar për pastrim është 14 punonjës, të cilët e ofrojnë shërbimin e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve me anë të fshesave dhe farashan.

Tabela 5 Sipërfaqet e rrugëve dhe shesheve që fshihen dhe pastrohen

Pastrimi i shesheve dhe trotuareve			
NJA	Sipërfaqe gjithsej (m ²)	Sipërfaqe që fshihen (m ²)	Sipërfaqe që lahen (m ²)
Tepelenë	950,000	550,000	
Kurvelesh	15,000	12,000	
Lopës	10,000	5,000	
Qendër Tepelenë	25,000	23,000	
Total	1,000,000	590,000	

3.2.5 Depozitimi i mbetjeve

Venddepozitimi Majkosh është i vetmi venddepozitim funksional që përdoret në Bashkinë Tepelenë me një sipërfaqe prej 4,900 m² miratuar me vendim të Këshilit Bashkiak nr. 7, datë 24.03.1998. Distanca nga vendbanimi më i afërt (fshati Majkosh) është më shumë se 300 m dhe nga rruga nacionale Tepelenë – Memaliaj është 1 km. Distanca nga shtrati i lumit Vjosë është afërsisht 30 m. Mungesa e masave të sigurisë si rrethimi i venddepozitimit krijon mundësinë e pranisë së kafshëve të ndryshme duke rritur mundësinë e përhapjes së sëmundjeve.



Figura 7 Foto nga ajri e vend depozitimit në Majkosh (majtas), foto në terren (djathtas)

Ky venddepozitim nuk ka sistem të grumbullimit/trajtimit të kullimit ose gazit. Nuk ka asnjë pajisje funksionale si peshore, roje apo rrethim.

Peizazhi përreth kësaj zone ka vlera turistike duke qenë se ndodhet afër luginës së lumit Vjosë, prandaj mbyllja dhe rehabilitimi i tij paraqet rëndësi të lartë.

3.2.6 Riciklimi

Bashkia aktualisht nuk ka ndërmarrë nisma të dedikuara për nxitjen e riciklimit përmes sigurimit të infrastrukturës së veçantë, si kontenierë të ndarë sipas fraksioneve apo pika grumbullimi. Aktivitetet e riciklimit mbeten të kufizuara dhe realizohen në sasi të vogla, ndërsa në territor operon vetëm një biznes që mbledh materiale të riciklueshme, kryesisht plastikë. Subjektet tregtare, veçanërisht marketet ushqimore, gjenerojnë sasi të konsiderueshme mbetjesh kartoni dhe ambalazhi, të cilat hidhen në kontenierët e zakonshëm, duke reduktuar kapacitetin e tyre efektiv dhe duke shkaktuar vendosjen e mbetjeve shtëpiake jashtë kontenierëve.

3.2.7 Mbetjet e biodegradueshme

Analiza merceologjike e mbetjeve tregon se rreth 61% e mbetjeve bashkiake në Bashkinë Tepelenë përbëhen nga mbetje organike, çka e bën këtë fraksion prioritet për ndërhyrje. Aktualisht, mbetjet organike ushqimore grumbullohen së bashku me mbetjet e përziera dhe dërgohen për depozitim, duke rritur ndjeshëm sasinë e mbetjeve që transportohen dhe kostot e menaxhimit të tyre.

Duke qenë një bashki me karakter kryesisht rural dhe me aktivitet të zhvilluar bujqësor e blegtoral, Tepelena gjeneron gjithashtu sasi të konsiderueshme mbetjesh të gjelbra nga mirëmbajtja e hapësirave publike, pemëtaritë dhe aktivitetet bujqësore, si edhe mbetje organike me origjinë shtazore. Megjithatë, në momentin e hartimit të këtij Plani nuk ekzistojnë praktika të organizuara për kompostimin e mbetjeve organike në nivel familjar apo komunitar, si dhe nuk janë ngritur struktura të dedikuara për trajtimin e tyre.

Një problematikë e veçantë evidentohet në zonat rurale, ku mbetjet me origjinë shtazore në disa raste depozitohen në kontenierët e mbetjeve urbane. Kjo praktikë vështirëson procesin e grumbullimit dhe transportit, përkeqëson kushtet higjieno-sanitare, shkakton erëra të pakëndshme dhe ndikon negativisht në pastërtinë e hapësirave publike. Po ashtu, mbetjet e gjelbra shpesh depozitohen së bashku me mbetjet e tjera ose në pika të përkohshme

grumbullimi, duke mos shfrytëzuar potencialin e tyre për kompostim dhe rikthim në përdorim si pleh organik.



Figura 8 Mbetje të gjelbra të hedhura në një pikë grumbullimi të mbetjeve

3.2.8 Rymat e tjera të mbetjeve

Mbetjet inerte nga ndërtimet dhe prishjet vijnë nga veprimtari të tilla si ndërtimi i infrastrukturës dhe i ndërtesave, shkatërrimi i pjesshëm ose i plotë i tyre, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve etj. Në zbatim të VKM nr 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", Bashkia Tepelenë përcakton në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes detyrimet që kanë personat fizikë ose juridikë (kompanitë e ndërtimit) që kanë marrë lejen, për t'i depozituar këto mbetje inerte në vendin e caktuar.

Venddepozitimi aktual i mbetjeve inerte i miratuar me VKB nr. 5, në datën 31.01.2024 ndodhet pranë Rrugës Kombëtare Tepelenë-Gjirokastrë, afër fshatit Luzat, me një sipërfaqe prej 6,075 m².



Figura 9 Venddepozitimi i mbetjeve inerte afër fshatit Luzat

Një nga sfidat kryesore të këtij venddepozitimi është prania e materialeve jo të përshtatshme, si plastmas, qese dhe materiale të tjera paketim, çka përkeqëson menaxhimin e mbetjeve. Siç tregohet dhe në foton e dytë, materialet inerte nga prishjet shpesh vijnë së bashku me thasët që përdoren për grumbullimin e tyre nga banesat.

Në zonën e qytetit, shpesh ndodh që mbetjet inerte nga ndërtimet të hidhen në rrugë ose hapësira publike. Mbetjet e krijuara nga punime civile, riparime dhe rikonstruksione zakonisht lihen pranë kontenierëve, duke krijuar një problem të vazhdueshëm për qytetin.

3.3 Ekonomia dhe financimi i menaxhimit aktual të mbetjeve

3.3.1 Buxheti vjetor dhe investimet

Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore përcakton të drejtën e bashkisë për të vendosur tarifa për shërbimin e ofruar dhe cilëson që niveli i tarifës orientohet në mbulimin e koston së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kërkon që bashkitë të përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe atë të “vetëmjaftueshmërisë”.

Sipas të dhënave të buxhetit të bashkisë të realizuar për vitin 2025, rezulton që buxheti për menaxhimin e mbetjeve përbën 9% të buxhetit total dhe 11% të buxhetit për shërbimet publike.

Tabela 6 Buxheti vjetor në vitet 2022 – 2024 për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Viti	Buxheti total i Bashkisë	Buxheti total për shërbimet publike	Buxheti total për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve		
	Lek	Lek	Lek	Pjesë e buxhetit total (%)	Pjesë e buxhetit të shërbimeve publike (%)
2022	220,000,000	19,870,000	12,616,000	6%	9%
2023	262,691,000	23,809,000	21,030,000	8%	9%
2024	355,324,881	37,494,000	35,396,000	10%	11%
2025	362,401,344	38,225,000	33,052,000	9%	11%

3.3.2 Ndarja e kostove

Tabela 7 Kostot e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Viti 2024									
Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vlera / muaj (lek)	Vlera / vit (lek)	% sipas strukturës buxhetore	Kosto transporti	Kosto pastrimi	Kosto depozitim i
1	Paga pune	Lek			12,271,956	36.58%	3,347,988	8,923,968	
	1-Shofer	numër	2	57,280	1,372,992		1,372,992		
	2-Punonjës mbështetës	numër	3	54,861	1,974,996		1,974,996		

Bashkia Tepelenë

	3-Pastrues	numër	1	54,834	658,008			658,008	
	4-Punëtor pastrimi	numër	15	45,922	8,265,960			8,265,960	
2	Sigurime shoqërore	Lek			1,951,992	5.82%	532,992	1,419,000	
	1-Shofer	numër	2	9,125	219,000		219,000		
	2-Punonjës mbështetës	numër	3	8,722	313,992		313,992		
	3-Pastrues	numër	1	8,750	105,000			105,000	
	4-Punëtor pastrimi	numër	15	7,300	1,314,000			1,314,000	
3	Shpenzime operative	Lek			11,803,578	35.19%	10,503,578	1,300,000	
	1-Karburant	litër	33,128	180	7,810,714		5,963,040		
	2-Vaj-filtra	copë			1,050,000		1,050,000		
	3-Goma	copë	18	41,141	740,538		740,538		
	4-Shpenzime riparimi	herë/vit	4	625,000	2,500,000		2,500,000		
	5-Blerje materiale pastrimi	herë/vit	4	62,500	250,000			250,000	
	6-Veshje pune	herë/vit	2	300,000	600,000			600,000	
	7-Siguracion mjeti+taksi	herë/vit	1	250,000	250,000		250,000		
	8-Vegla pune	herë/vit	2	225,000	450,000			450,000	
4	Mirëmbajtje fusha e mbetjeve	herë/vit	4	1635,000	6,500,000	19%			6,500,000
5	Investime	Lek			1,018,800	3.04%		1,018,800	
	1-Blerje kontenier	copë	20	50,940				1,018,800	
	TOTALI I KOSTOS	Lek			35,396,000	100%	14,384,558	12,661,768	6,500,000

Për vitin 2024 bashkia 35,396,000 lekë e barabartë me 1,312 lekë/banor llogaritur me 60% të vlerës së koston sipas popullsisë së Regjistrimit Civil dhe 2,977 lekë/ banor sipas popullsisë së Census 2023. Kjo kosto përfshin ofrimin e shërbimit për të gjitha familjet dhe bizneset në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Nga të dhënat e tabelës së koston vihet re se:

1. Pagat e punës dhe sigurimet shoqërore zënë 42.4% të shpenzimeve totale vjetore, nga të cilat:

- Për transportin e mbetjeve paguhen 5 punonjës me kosto vjetore 3,880,980 lekë.
- Për shërbimet e pastrimit paguhen 16 punonjës pastrimi me kosto vjetore 10,342,968 lekë.

2. Shpenzimet operative ku janë përllogaritur të gjitha shpenzimet zënë 54.56% të koston vjetore nga të cilat:

- Për transportin e mbetjeve 10,503,578 lekë nga kostoja vjetore
- Për shërbimet e pastrimit, përdoren 130,000 lekë nga kostoja vjetore.

c. Për mirëmbajtje tek fusha e mbetjeve janë shpenzuar 6,500,000 lekë.

3. Investimet zënë vlerën më të vogël të kostos, të barabartë me 3.04% të saj. Vlera prej 1,018,800 lekë është përdorur për blerje kontenierësh.

3.3.3 Tarifat dhe të ardhurat e planifikuara

Sipas tabelës së mëposhtme për vitin 2025 bashkia kishte planifikuar pagesën e tarifës nga 2,655 familje. Vlera e parashikuar për të ardhurat nga tarifa e shërbimit është 1,800,000 lekë në vit. Nga familjet e faturuara, 704 familje janë me pensionistë, 221 familje me ndihmë ekonomike dhe 325 familje me persona invalidë, tetraplegjikë etj.

Tabela 8 Niveli i tarifave dhe të ardhurat për vitin 2025

Nr.	Tarifa e shërbimit MM sipas Paketës Fiskale për familje dhe institucione	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale (numër)	Tarifa e miratuar në paketën fiskale (lek/vit)	Vlera e planifikuar në buxhetin e bashkisë (lek/vit)
1	Tarifa familjare e planifikuar	2,655	678	1,800,000
	a) Tarifa për familjet Tepelenë	1,918	1,300	1,500,000
	b) Tarifa për familjet NJA Qendër	425	650	170,000
	c) Tarifa për familjet NJA Kurvelesh	237	650	100,000
	d) Tarifa për familje NJA Lopës	75	650	30,000
2	Tarifë institucione shtetërore	15	15,600	200,000
3	Tarifë shoqata jofitimprurëse			0

Mbledhja e tarifave të familjeve bëhet nga ShaUK për zonën e mbulimit ndërsa detyrimet e familjeve të tjera mbledhen nga administratorët e njësive administrative.

Tabela 9 Niveli i tarifave dhe të ardhurave për vitin 2025

Nr	Tarifa e shërbimit MM sipas Paketës Fiskale për bizneset	NJA	Baza e tatueshme sipas paketës fiskale (numër)		Tarifa e miratuar në paketën fiskale (lek/vit)		Vlera e planifikuar në buxhetin e bashkisë (lek/vit)
4	Biznese		Biznes i vogël	Biznes i madh	Biznes i vogël	Biznes i madh	
a	Njësi tregtare dhe shërbimi	NJA Tepelenë	341		9,100		1,100,000

		NJA të tjera		114		39,000	1,667,000
b	Njësi tregtare për tregtim karburanti			5		32,500	100,000
c	Njësi prodhimi		7		9,100		30,000
d	Subjekte ndërtimi të ndara sipas vlerës së investimit					26,000-195,000	
e	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritare						
f	Profesione të lira		27		9,100		150,000
g	Tregtar ambulant		14		2,600		30,000
SHUMA			508		2,578	14,849	3,077,000

Biznese në total janë 508, ku 389 prej tyre janë biznes i vogël dhe 119 prej tyre janë biznes i madh.

Vlera e parashikuar për të ardhurat nga tarifa e shërbimit për biznesin e vogël është 1,310,000 lekë në vit ndërsa për biznesin e madh 1,767,000 lekë në vit. Tarifa nga bizneset mbledhet nga administrata e tatim taksave të bashkisë.

Sipas tabelës më poshtë burimi kryesor i financimit të shërbimit për vitin 2025 vjen nga Qeveria qendrore (51%). Bashkia planifikonte të mbulonte vetëm 16% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2025. Për vitin 2024, bashkia ka përdorur më shumë fonde për menaxhimin e mbetjeve dhe mbulimi i shpenzimeve të realizuara nga tarifrat ishte në nivele më të larta (23%). Rritja e mbulimit nuk vjen nga familjet, por nga mbledhja e më shumë të ardhurave nga bizneset.

Tabela 10 Burimet e financimit të menaxhimit të mbetjeve në vitin 2024 dhe 2025

Burimet e financimit të menaxhimit të mbetjeve					
Shpenzime në Lekë	Nga TS/QQ ¹	Nga tarifa e shërbimit MM			Nga burime të tjera të vetë bashkisë
		Totali	Nga kjo:		
			Nga	Nga biznesi dhe	

¹Këto fonde janë një mekanizëm financiar shtesë që mbështet bashkinë për mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane. Shuma merr parasysh a) sasinë e mbetjeve vjetore dhe b) kostot shtesë përtransportin e tyre në pikat fundore të grumbullimit dhe përpunimit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave monitoron periodikisht përdorimin e fondit shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane sipas bashkive përfituese.

				familjet	Institucionet	
Plan viti 2025	33,052,000	16,977,000	5,077,000	1,800,000	3,277,000	10,998,000
	% e planifikuar e mbulimit të kostos	51%	16%	6%	10%	33%
Fakt viti 2024	34,892,000	16,325,000	8,142,000	2,238,000	5,904,000	10,425,000
	% në fakt e mbulimit të kostos	47%	23%	6%	17%	30%

Tarifa për shërbimin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane për kategorinë familje është 1,300 lek/vit për zonat urbane dhe 650 lek/vit për zonat rurale dhe kategoritë e tjera të paraqitura në tabelën e mësipërme, e ndryshuar kjo tarifë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 85, datë 01.12.2023 "Për paketën fiskale për vitin 2024".

Analiza financiare tregon se shërbimi i menaxhimit të mbetjeve mbështetet në një kombinim të fondeve të buxhetit qendror, vendor dhe të ardhurave nga tarifa e pastrimit. Struktura e kostove dominohet nga shpenzimet operative, ndërsa investimet për modernizimin e sistemit përbëjnë një pjesë të kufizuar të shpenzimeve totale. Në këtë kontekst, zhvillimi i mëtejshëm i sistemit dhe përmbushja e objektivave të Planit do të kërkojnë rritjen graduale të eficiencës financiare, përmirësimin e administrimit dhe arkëtimit të tarifës, si dhe sigurimin e burimeve shtesë për financimin e investimeve prioritare. Këto gjetje përbëjnë bazën për objektivat dhe masat e propozuara në kapitujt vijues.

3.4 Indikatorët e performancës

Performanca e sistemit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve vlerësohet nëpërmjet një grupi indikatorësh, të cilët mundësojnë analizimin e eficiencës së shërbimit, mbulimit territorial, qëndrueshmërisë financiare, përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe progresit drejt objektivave të ekonomisë qarkulluese. Këta indikatorë përbëjnë nivelin bazë (baseline) të Planit Vendor dhe do të shërbejnë si referencë për monitorimin e rezultateve gjatë periudhës së zbatimit.

Përzgjedhja e indikatorëve është bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", VKM nr. 687/2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", ndryshuar me VKM 538 datë 22.09.2021), objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe në metodologjitë e menaxhimit të performancës së bashkive të zhvilluara në kuadër të projektit "Bashki të Forta", të cilat promovojnë përdorimin e treguesve të standardizuar, të matshëm dhe të verifikueshëm.

Në fazën aktuale, analiza tregon se performanca e sistemit karakterizohet kryesisht nga mbulimi i shërbimit bazë të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, ndërkohë që elementët e ekonomisë qarkulluese, si ndarja në burim, riciklimi dhe trajtimi i mbetjeve biodegradueshme, mbeten në faza fillestare zhvillimi. Po kështu, analiza financiare evidenton nevojën për rritjen graduale të eficiencës së kostove dhe përmirësimin e rikuperimit të tyre, në mënyrë që sistemi të jetë financiarisht i qëndrueshëm në afat të gjatë.

Vlerat bazë të këtyre indikatorëve paraqiten në tabelat e kapitujve përkatës të analizës së situatës ekzistuese dhe do të përditësohen çdo vit përmes sistemit të monitorimit të Bashkisë, në përputhje me kërkesat e AKEM, AKM dhe sistemit kombëtar të statistikave të mbetjeve.

Tabela 11 Indikatorët e performancës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Indikatori	Njësia	Vlera bazë 2025	Objektivi 2031	Burimi i të dhënave
Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	%			Bashkia
Mbetje të grumbulluara	ton/vit			Bashkia
Gjenerimi për frymë	kg/banor/vit			Bashkia/AKEM
Ndarja në burim	%			Bashkia
Riciklimi	%			Operatorët
Mbetje bio të devijuara	%			Bashkia
Mbetje të depozituara në landfill	%			Bashkia
Kosto e shërbimit	lek/ ton			Bashkia
Kosto për banor	lek/banor			Bashkia
Norma e arkëtimit të tarifës	%			Bashkia
Shkalla e mbulimit të kostos për MM nga të ardhurat e tarifës së shërbimit	%			Bashkia
Ankesa të trajtuara	%			Bashkia
Pika informale të rehabilituara	nr			Bashkia

3.5 Ndërgjegjësimi i publikut dhe shmangia e mbetjeve

Përfshirja aktive e qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve është një ndër faktorët kryesorë për suksesin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Për këtë arsye, krahas analizës teknike të sistemit ekzistues, gjatë hartimit të Planit u zhvilluan konsultime me aktorët lokalë dhe u analizua perceptimi i qytetarëve, me qëllim që masat e propozuara të reflektojnë nevojat reale të komunitetit dhe të sigurojnë zbatimin efektiv të tyre.

Në takimin me përfaqësues të sektorit privat dhe OSHC në datë 26.09.2025, u diskutua rreth shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ofruar nga bashkia. Opinionet e aktorëve lokalë tregojnë një interes dhe angazhim të lartë për përmirësimin e shërbimeve bashkiake, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe informimit të komunitetit. Evidentohej nevoja për forcimin e komunikimit mes bashkisë dhe qytetarëve përmes takimeve periodike me lagjet, njësitë administrative dhe fshatrat, me qëllim rritjen e transparencës, identifikimin në kohë të problematikave dhe informimin mbi shërbimet ekzistuese. Njëkohësisht, aktorët lokalë nënvizojnë rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit qytetar, përmirësimit të monitorimit të

shërbimeve dhe përdorimit të instrumenteve informuese dhe edukuese, si fushatat, posterat dhe aktivitetet komunitare, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe institucionet arsimore.

Në të njëjtën kohë, bizneset lokale shprehin gatishmëri konkrete për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë, përmes përfshirjes në proceset e riciklimit dhe përpunimit të mbetjeve plastike, inerte dhe të ambalazhit. Potenciali për rritjen e nivelit të riciklimit konsiderohet i mirë, veçanërisht nëse realizohet ndarja e mbetjeve në burim dhe krijohen mekanizma mbështetës nga qeverisja vendore. Ky interes përbën një mundësi konkrete për zhvillimin e partneriteteve publiko-private në mbështetje të grumbullimit të diferencuar, riciklimit dhe ripërdorimit të materialeve, masa të cilat janë reflektuar në Objektivin Strategjik 2 të këtij Plani. Megjithatë zhvillimi i ekonomisë qarkulluese në nivel vendor nuk varet vetëm nga investimet në infrastrukturë, por edhe nga ndryshimi i sjelljes së qytetarëve dhe bizneseve në lidhje me parandalimin, ripërdorimin dhe ndarjen e mbetjeve në burim. Përvojat pozitive të fushatave të pastrimit dhe aktivitetet edukuese në shkolla vlerësohen si praktika të mira, mbi të cilat mund të ndërtohen nisma të reja për përfshirjen më aktive të nxënësve, familjeve dhe komunitetit të gjerë në ruajtjen e mjedisit.



Figura 10 Dita e Tokës, 22 prill 2026

Perceptimi i publikut për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve

Gjatë procesit të hartimit të Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, Bashkia Tepelenë mbështetur nga projekti ka publikuar në faqen zyrtare një pyetësor për të matur cilësinë e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në bashki. Pjesëmarrja e qytetarëve nuk ka qenë shumë aktive Gjithsej 40 persona kanë plotësuar pyetësorin, nga të cilët 80% janë banorë në zonën urbane dhe 20% në zonat rurale (njësitë administrative Qendër 12.5% dhe Kurvelesh 7.5%). Sipas përgjigjeve të raportuara 95% e të anketuarve marrin shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe pastrimit të rrugëve.

2.1. Nëse po, sa të kënaqur jeni ju me cilësinë e shërbimit të pastrimit në zonën ku ju banoni?

[Copy](#)
[chart](#)

40 responses




Tre të katërtat e banorëve janë shprehur se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të pastrimit, 17.5% e tyre kanë pasur një vlerësim neutral dhe vetëm 7.5% janë shprehur të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me shërbimin. Rezultatet tregojnë se, megjithëse qytetarët kanë një perceptim përgjithësisht pozitiv për shërbimin, ekziston ende hapësirë e konsiderueshme për përmirësimin e cilësisë dhe mbulimit të tij.

2.2. Nëse jo, cilat prej alternativave të mëposhtme ju mendojnë që ndikon më shumë në cilësinë aktuale të shërbimit të pastrimit në zonën ku ju banoni?

[C](#)
[C](#)

30 responses



Sipas banorëve që kanë marrë pjesë në anketë, në cilësinë aktuale të shërbimit ndikon më shumë hedhja e mbetjeve jashtë kontejnerëve (73%). Arsyet e dyta kryesore janë numri i pamjaftueshëm i kontejnerëve dhe frekuenca e pamjaftueshme e shërbimit. Më shumë se një e treta e banorëve mendojnë se numri i kontejnerëve nuk është i mjaftueshëm. 27.5% e tyre raportojnë se në zonat ku ata banojnë ka prani të vendgrumbullimeve të paligjshme të mbetjeve. Ato vihen re anës rrugëve automobilistike, në periferi të qytetit, pranë lumenjve dhe përrenjve, në hapësirat pranë tokave bujqësore dhe në oborret e pallateve. Ndërsa lidhur me pastërtinë e rrugëve dhe shesheve kryesore, 30% e banorëve të anketuar shprehen se ato janë shumë të pastra dhe 47.5% të pastra. Rexhin Lluף përmendet si një zonë ku nuk ofrohet shërbimi i pastrimit. Këto rezultate tregojnë se problematika kryesore lidhet më shumë me sjelljen e përdoruesve dhe organizimin e pikave të grumbullimit sesa me mungesën e shërbimit.

Të pyetur nëse janë të gatshëm të paguajnë një tarifë pastrimi më të lartë për të pasur cilësi më të mirë shërbimi, vetëm 43% e të anketuarve janë dakord. Fakti që më pak se gjysma e të anketuarve shprehen të gatshëm të paguajnë një tarifë më të lartë tregon se përmirësimi i shërbimit duhet të shoqërohet me rritjen e transparencës, komunikimit dhe besimit të qytetarëve mbi përdorimin e tarifës së pastrimit.

6. Sipas mendimit tuaj si do të vlerësonit ju shkallën e pastërtisë së rrugëve dhe shesheve kryesore në bashkinë tuaj?

40 responses

[Copy](#)

[chart](#)




Lidhur me informimin rreth shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve (grumbullimit, transportit dhe vendit ku asgjeshohen mbetjet), 67% e banorëve kanë informacion. Ata informohen kryesisht nëpërmjet faqes së internetit dhe rrjeteve sociale të bashkisë (49%), nga rrethi i tyre shoqëror (23%) dhe nëpërmjet informacionit që shoqëron faturen (14%). Ky rezultat tregon se rrjetet sociale dhe kanalet digjitale të bashkisë përbëjnë instrumentin kryesor të komunikimit me qytetarët dhe duhet të mbeten kanalet prioritare për aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimit. Vetë banorët mund të ndikojnë në përmirësimin e shërbimit të pastrimit duke hedhur mbetjet në vendin e caktuar (69%), duke mbajtur pastër hapësirat publike (67%), por edhe duke paguar tarifën e pastrimit (28%).

11. Sipas mendimit tuaj si mund të ndikojnë qytetarët në përmirësimin e shërbimit të pastrimit? Ju lutem zgjidhni nga 1 deri në 3 nga alternativat e mëposhtme

39 responses


[Copy](#)

[chart](#)



Për sa i përket masave që duhet të marrë Bashkia për përmirësimin e cilësisë së shërbimit, qytetarët janë shprehur se duhet të vendosen gjoba për individët që hedhin mbetjet në mënyrë të pakontrolluar (47.5%), të përmirësohet ofrimi i infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve (37.5%) si edhe të intensifikohet komunikimi me banorët (37.5%). Gjithashtu 35% e të anketuarve mendojnë se duhet të shtohet numri i punëtorëve, të rritet frekuenca e

shërbimit (30%) dhe të shtohet numri i kontenierëve (30%). Vetëm 15% e banorëve të pyetur mendojnë se duhet të rritet tarifa e pastrimit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.



Në tërësi, rezultatet e pyetësorit tregojnë se qytetarët e vlerësojnë pozitivisht shërbimin aktual, por identifikojnë si prioritete përmirësimin e infrastrukturës së grumbullimit, rritjen e disiplinës në përdorimin e kontenierëve, forcimin e monitorimit dhe komunikimin më të mirë me komunitetin. Këto gjetje kanë shërbyer si bazë për hartimin e Objektivit Strategjik 5, i cili parashikon zhvillimin e një programi të vazhdueshëm komunikimi, edukimi mjedisor dhe ndërgjegjësimi për qytetarët, bizneset dhe institucionet arsimore, në mbështetje të zbatimit të të gjitha objektivave të tjera të Planit Vendor.

Konsultimet me aktorët lokalë dhe rezultatet e pyetësorit tregojnë se ekziston një bazë e mirë për përfshirjen e komunitetit në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, për të arritur objektivat e Planit Vendor do të jetë i nevojshëm forcimi i vazhdueshëm i komunikimit me qytetarët, zgjerimi i programeve të edukimit mjedisor, promovimi i ndarjes së mbetjeve në burim dhe krijimi i mekanizmave të rregullt të konsultimit dhe raportimit me komunitetin. Këto gjetje janë reflektuar në Objektivin Strategjik 5 të këtij Plani.

3.6 Sfidat kryesore dhe analiza SËOT e sistemit vendor të menaxhimit të mbetjeve

Analiza e situatës ekzistuese tregon se Bashkia Tepelenë ka ngritur një sistem funksional të menaxhimit të mbetjeve, i cili siguron organizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit në përputhje me kompetencat ligjore të njërive të vetëqeverisjes vendore. Megjithatë, zhvillimet e fundit në kuadrin ligjor dhe objektivat kombëtare për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese kërkojnë një transformim gradual të sistemit ekzistues, duke kaluar nga menaxhimi tradicional i mbetjeve drejt një modeli të integruar, të qëndrueshëm dhe të orientuar nga performanca.

Një nga sfidat kryesore lidhet me karakteristikat territoriale të bashkisë. Shtrirja e gjerë gjeografike, relievi malor, shpërndarja e popullsisë në një numër të madh vendbanimesh dhe ulja graduale e numrit të banorëve ndikojnë në rritjen e kostove operative dhe në vështirësitë për garantimin e një shërbimi efikas dhe ekonomik në të gjithë territorin. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i turizmit dhe mbrojtja e zonave me vlera të larta natyrore kërkojnë standarde gjithnjë e më të larta të pastërtisë dhe menaxhimit mjedisor.

Sistemi aktual mbështetet kryesisht në grumbullimin e përzier të mbetjeve, ndërsa ndarja në burim, riciklimi dhe trajtimi i mbetjeve biodegraduese mbeten në fazat fillestare të zhvillimit.

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Përmbushja e objektivave të legjislacionit kombëtar dhe kërkesave të Bashkimit Evropian do të kërkojë investime graduale në infrastrukturë, organizim institucional, bashkëpunim me operatorët e përgjegjësishë së zgjeruar të prodhuesit dhe rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në ndarjen e mbetjeve.

Nga analiza financiare rezulton se garantimi i qëndrueshmërisë ekonomike të shërbimit mbetet një ndër sfidat kryesore të periudhës së planifikimit. Përmirësimi i eficiencës operacionale, optimizimi i kostove, rritja e shkallës së arkëtimit të tarifës dhe identifikimi i burimeve të reja të financimit për investime do të jenë elementë kyç për zhvillimin e sistemit në afatgjatë.

Njëkohësisht, zbatimi i kërkesave të reja ligjore kërkon forcimin e kapaciteteve institucionale të Bashkisë, përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe raportimit të të dhënave, si dhe zhvillimin e indikatorëve të performancës që mundësojnë vlerësimin objektiv të progresit dhe mbështesin vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Në këtë kontekst, analiza SËOT paraqet në mënyrë të përmbledhur faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e sistemit vendor të menaxhimit të mbetjeve dhe shërben si bazë për përcaktimin e objektivave strategjikë dhe masave prioritare të këtij Plani.

Pikat e forta

Sistem i organizuar i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

Përvojë institucionale në organizimin e shërbimit.

Pasuri të rëndësishme natyrore dhe potencial për zhvillim të qëndrueshëm.

Kuadër i ri ligjor që krijon bazë për modernizimin e sektorit.

Dobësitë

Mungesë e sistemeve të zhvilluara për ndarjen në burim dhe riciklimin.

Kosto të larta operative për shkak të relievit dhe shpërndarjes së popullsisë.

Kapacitete të kufizuara për monitorimin e performancës dhe administrimin e të dhënave.

Infrastrukturë që kërkon modernizim dhe zgjerim gradual.

Mundësitë

Mbështetja nga AKEM dhe organizimi i Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve.

Financime nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për ekonominë qarkulluese.

Zhvillimi i sistemeve të përgjegjësishë së zgjeruar të prodhuesit.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit.

Kërcënimet

Rënia e popullsisë dhe emigracioni.

Rritja e kostove të operimit dhe transportit.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe fenomenet ekstreme natyrore.

Vonesa në zhvillimin e infrastrukturës rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Rezultatet e kësaj analize janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të objektivave strategjikë dhe Planit të Veprimit, duke siguruar që çdo masë e propozuar të adresojë një ose më shumë nga sfidat e identifikuara në analizën e situatës ekzistuese.

4. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE MBETJEVE

4.1 Fushëveprimi i planit vendor të MIM

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Tepelenë shtrihet në një afat kohor 5-vjeçar 2026–2031 dhe paraqet perspektivat e zbatimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë qytetin e Tepelenës dhe njësitë administrative Qendër Tepelenë, Kurvelesh dhe Lopës.

Ky Plan përcakton rregullat për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve bashkiake që gjenerohen në territorin e bashkisë, duke marrë në konsideratë burimet e gjenerimit, sasi të, përbërjen e mbetjeve, infrastrukturën që mundëson proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe skemat e organizimit të tyre.

Sipas Katalogut të Mbetjeve, të miratuar me VKM nr. 402 datë 30.06.2021, emërtohen si mbetje urbane (kategoria 20) mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetjet industriale dhe institucionale të ngjashme, përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas. Strategjia Kombëtare MIM 2020–2035 përcakton mbetjet bashkiake, për menaxhimin e të cilave janë përgjegjëse Bashkitë, ku përfshihen:

- mbetjet shtëpiake dhe të ngjashme,
- mbetjet e vëllimshme,
- mbetjet e kopshteve, gjethet, degët nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugëve dhe tregjeve publike (mbetjet bio)
- mbetjet nga aktivitetet tregtare, bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet
- mbetjet nga shërbimet e tjera bashkiake si parqet, lulishtet, etj. (mbetjet bio)

Objekt i veprimtarisë së Bashkisë Tepelenë në fushën e menaxhimit të mbetjeve është pastrimi i rrugëve dhe shesheve, grumbullimi, transportimi, trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të krijuara në territorin që bashkia administron.

Burimet kryesore të gjenerimit të mbetjeve të ngurta bashkiake janë (1) familjet, (2) bizneset dhe (3) institucionet. Por referuar Strategjisë Kombëtare, duhet të merren parasysh edhe mbetjet nga pastrimi i hapësirave publike dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra. Në zbatim të legjislationit dhe për të arritur synimet për shmangien e mbetjeve nga vend depozitimi, Bashkia Tepelenë do të fillojë iniciativat për ndarjen e mbetjeve në burim në zonën urbane.

Nuk përfshihen në llogaritjen e kostos dhe nuk përfshihen në largimin publik të mbetjeve:

1. Mbetjet radioaktive.
2. Mbetjet nga puna kërkimore, industria nxjerrëse e përpunuese e trajtimit dhe e grumbullimit të pasurive minerare të shfrytëzimit të vendburimeve të ndryshme.
3. Toka, balta, bora, akulli, fekalet, mbeturinat që vijnë nga lëndë të shuara ose të nxehta.
4. Mbeturina zanati, papastërtitë e stallave, kadavrat, lëngjet, mbetjet e vajrave lubrifikante e të benzinës.
5. Lëngjet eksplozive, substancat gërryese, mbetjet e ngjyrave e të karbiteve.
6. Ngordhësit.

7. Mbetjet bujqësore.
8. Lëndët shpërthyesë dhe eksplozive.
9. Materialet fekale.
10. Mbetjet nga ndërtimet dhe meremetimet e objekteve e të veprave me përmasa mbi $1/10 \text{ m}^3$.
11. Lëndët materiale të tjera që ndodhen jashtë vijës kufizuese të qyteteve a komunave, si dhe lëndë e materiale të tjera që parashikohen e disiplinohen me ligje të veçanta.
12. Mbetjet e tjera të çdo lloji që gjatë largimit të tyre shkaktojnë dëmtime dhe mund të vënë në rrezik organizma që merren me largimin e tyre, nxjerrin në ajër lëndë të ndryshme, sjellin shkatërime etj.

Klasifikimi dhe përcaktimi konkret i mbetjeve dhe i natyrës së tyre do të bëhet në rregulloren e shërbimit të pastrimit.

4.1.2 Zona e Menaxhimit të Mbetjeve

Për një organizim më të mirë të shërbimeve dhe efijencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrativë të bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

- Nënzona e parë: Zona urbane
- Nënzona e dytë.
- Nënzona e tretë:
- Nënzona e katërt:

4.1.3 Parashikimi i popullsisë

Të dhënat për popullsinë dhe zhvillimin e saj janë baza për llogaritjen e sasive aktuale dhe të ardhshme të mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara. Studimi Sektorial për Kërkesën për Investime për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri (Vendim i KKT Nr. 1, datë 13.01.2020) citon metodologjinë për parashikimin e popullsinë dhe mbetjeve siç përshkruhet në vijim. Shifrat e përlogaritura janë pranuar nga të gjitha palët e interesit.

Të dhënat e popullsisë nga Regjistri i Gjendjes Civile janë përgjithësisht shumë më të larta se shifrat sipas Censurit, dhe për këtë arsye janë përdorur shifrat e Census 2023.

Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e popullsisë sipas njësive administrative, ndërsa figura e mëposhtme ilustron zhvillimin dhe shpërndarjen demografike.

Tabela 12 Parashikimi i popullsisë deri në vitin 2035 sipas njësive administrative

Parashikimi i popullsisë për Njësitë Administrative

Viti	Tepelenë	Qendër Tepelenë	Kurvelesh	Lopës	Gjithsej
2025	3,700	2,036	499	517	6,752
2026	3,654	1,975	487	505	6,621
2027	3,609	1,916	475	493	6,493
2028	3,565	1,858	463	481	6,368
2029	3,521	1,803	452	470	6,245
2030	3,478	1,749	441	458	6,126
2031	3,437	1,696	430	448	6,009
2032	3,392	1,646	420	437	5,895
2033	3,351	1,596	410	427	5,783
2034	3,309	1,548	400	416	5,674
2035	3,269	1,502	390	407	5,567

Duket qartë se gjatë periudhës së planifikimit shumica e popullsisë jeton në njësinë administrative të Tepelenës dhe popullsia në bashki është në rënie gjatë periudhës së parashikuar.




Figura 11 Zhvillimi dhe shpërndarja e popullsisë në bashkinë e Tepelenës sipas njësive administrative

4.1.4 Parashikimi i volumeve

4.1.4.1 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve

Parashikimet e gjenerimit të mbetjeve të paraqitura në këtë Plan janë bazuar kryesisht në projeksionet demografike dhe në të dhënat historike të gjenerimit të mbetjeve, të cilat përbëjnë bazën më të besueshme të informacionit në nivel vendor. Megjithatë, sasia dhe përbërja e mbetjeve mund të ndikohen edhe nga faktorë të tjerë, si zhvillimi ekonomik, aktiviteti turistik, lëvizjet sezonale të popullsisë, migracioni, ndryshimet në modelet e konsumit, si dhe zbatimi i

masave për parandalimin e mbetjeve, ndarjen në burim dhe riciklimin. Për shkak të mungesës së të dhënave të plota dhe të konsoliduara për këta faktorë në nivel bashkiak, ata nuk janë përfshirë në modelin sasior të parashikimit, por do të merren në konsideratë gjatë rishikimit periodik të Planit, bazuar në të dhënat e monitorimit dhe zhvillimet aktuale në territor.

Bazuar në parashikimin e popullsisë dhe normën e supozuar të sasive që gjenerohen në tipe të ndryshme vendbanimesh, siç tregohet në tabelën e mëposhtme, është përllogaritur gjenerimi i mbetjeve të parashikuara gjatë periudhës së planifikimit. Koeficientët e përdorur për llogaritjen e gjenerimit të mbetjeve janë 0.7 kg/banor/ditë për zonën urbane dhe 0.4 kg/banor/ditë për zonën rurale.

Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve – Bashkia Tepelenë 2025-2035 (ton/vit)					
Viti	Tepelenë	Qendër Tepelenë	Kurvelesh	Lopës	Gjithsej
2025	1003,8t	297,3t	72,9t	75,5t	1449t
2026	995,0t	288,3t	71,1t	73,7t	1428t
2027	986,6t	279,7t	69,3t	71,9t	1408t
2028	978,4t	271,3t	67,7t	70,2t	1388t
2029	970,6t	263,2t	66t	68,5t	1368t
2030	963,1t	255,3t	64,4t	66,9t	1350t
2031	955,8t	247,7t	62,8t	65,3t	1332t
2032	948,9t	240,2t	61,3t	63,8t	1314t
2033	942,4t	233t	59,8t	62,3t	1298t
2034	936,1t	226,1t	58,4t	60,8t	1281t
2035	930,2t	219,3t	56,9t	59,4t	1266t

Llogaritja është bazuar duke përdorur koeficientët e gjenerimit të mbetjeve/ banorë, duke qenë se bashkia Tepelenë nuk ka të dhëna të sakta për sasitë e mbetjeve që gjenerohen.

4.1.4.2 Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve

Sasitë e grumbulluara të mbetjeve ndryshojnë nga shumatat e gjeneruara të mbetjeve, për shkak se shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk mbulojnë të gjitha zonat, veçanërisht në zonat rurale. Si rrjedhojë, për parashikimin e grumbullimit të mbetjeve, supozohen normat e grumbullimit të mbetjeve.


Njësia Administrative	[%] e grumbullimit të mbetjeve
Tepelenë	95
Qendër Tepelenë	70
Kurvelesh	85
Lopës	60

NJA	Mbetje që grumbullohen mesatarisht (t/ditë)	Mbetje që grumbullohen mesatarisht (t/vit)
Tepelenë	2,6	950
Kurvelesh	0,2	75
Lopës	0,2	80
Qendër Tepelenë	1,4	520
Total	4,4	1625

Gjithashtu, parashikohet se do të rritet mbulimi i grumbullimit me 0.5% në zonën urbane dhe me 1% në të gjitha zonat e tjera në çdo vit.

Bazuar në supozimet e përshkruara më lart, tabela në vijim tregon parashikimin e grumbullimit të mbetjeve në nivel bashkie.

Projeksioni i grumbullimit të mbetjeve 2025-2035 (ton/vit)					
Viti	Tepelenë	Qendër Tepelenë	Kurvelesh	Lopës	Gjithsej
2025	955,0t	178,4t	61,9t	52,8t	1248t
2026	951,4t	174,7t	61,0t	52,1t	1239t
2027	948,0t	171,2t	60,1t	51,4t	1231t
2028	944,7t	167,7t	59,3t	50,6t	1222t
2029	941,7t	164,3t	58,4t	49,9	1214t
2030	939,0t	161t	57,5t	49,3t	1207t
2031	936,5t	157,7t	56,7t	48,6t	1199t
2032	934,2t	154,5t	55,9t	47,9t	1192t
2033	932,2t	151,4t	55,1t	47,2t	1186t
2034	930,4t	148,3t	54,3t	46,6t	1180t
2035	930,2t	145,3t	53,5t	45,9t	1175t



Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Figura 12

Projeksioni i gjenerimit dhe grumbullimit të mbetjeve deri në vitin 2035

Në interpretimin e projeksioneve duhet të mbahet parasysh se, ndërsa zhvillimi ekonomik dhe rritja e aktivitetit turistik mund të sjellin rritje të përkohshme të sasisë së mbetjeve të gjeneruara, zbatimi progresiv i masave të parandalimit, rritja e ndarjes në burim dhe devijimi i materialeve të riciklueshme dhe biodegraduese nga depozitimi pritet të kufizojnë rritjen e sasisë së mbetjeve që kërkojnë grumbullim dhe trajtim final. Për këtë arsye, parashikimet do të rishikohen periodikisht gjatë zbatimit të Planit, bazuar në të dhënat e monitorimit dhe ndryshimet në treguesit demografikë, ekonomikë dhe të performancës së sistemit.

4.2 Kuadri Strategjik

4.2.1 Vizioni

Grupi i Punës dhe palët e interesuara, me anë të vizionit në këtë Plan, shprehin ambicien e komunitetit të Tepelenës në fushën e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe menaxhimit të mbetjeve.

“Bashkia Tepelenë synon një mjedis të pastër dhe një komunitet të angazhuar në menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke promovuar minimizimin e mbetjeve, ruajtjen e burimeve natyrore dhe promovimin e një jetese të shëndetshme.”

Vizioni shërben si udhërrëfyes për komunitetin, qeverinë bashkiake dhe partnerët duke frymëzuar përpjekje të përbashkëta për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve, ofrim shërbimi efikas, efektiv dhe me vlerë të shtuar për fondet publike dhe përfshirje të lartë të komunitetit.

4.3 Objektivat strategjikë

Nëpërmjet këtij plani Bashkia Tepelenë synon të arrijë këta objektiva strategjikë që shprehin vizionin e saj:

OS 1	<i>Parandalimi i krijimit të mbetjeve</i>
OS 2	<i>Zhvillimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit, sektorit privat dhe shoqërisë civile.</i>
OS 3	<i>Forcimi i kapaciteteve institucionale, administrative dhe teknike të Bashkisë Tepelenë për menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve dhe zhvillimi i kuadrit rregullator në përputhje me legjislacionin.</i>
OS 4	<i>Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve përmes ofrimit eficient të shërbimit, duke garantuar mbulimin e kostove dhe përbalueshmërinë e tarifës.</i>
OS 5	<i>Forcimi i kulturës së reduktimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve</i>

përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe bizneseve.

4.3.1 Objektivi strategjik 1: Parandalimi i krijimit të mbetjeve

Bashkia e Tepelenës synon mirëmenaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore dhe për rrjedhojë reduktimin e mbetjeve të gjeneruara duke iu përmbajtur Direktivës për Mbetjet dhe Planit të Veprimit të Paktit të Gjelbër dhe parimeve të Ekonomisë Qarkulluese.

Parandalimi qëndron në krye të hierarkisë së mbetjeve si opsioni më i preferuar për menaxhimin e mbetjeve, i ndjekur nga përgatitja për ripërdorim, riciklimi, format e tjera të rikuperimit të mbetjeve dhe, në fund, asgjësimi. Në përputhje me Ligjin nr 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe me VKM nr 286 datë 17.04.2026 "Për miratimin e Programit Kombëtar për parandalimin e krijimit të mbetjeve", në këtë plan vendor janë përfshirë disa masa për parandalimin e mbetjeve. Politikat e Bashkisë inkurajojnë reduktimin e produkteve të cilat kthehen në mbetje, duke nxitur operatorët ekonomikë që të përqafojnë nisma miqësore me mjedisin, nga njëra anë, dhe duke ndërmarrë aktivitete ndërgjegjësuere për konsumimin e produkteve dhe shërbimeve miqësore me mjedisin nga komuniteti, nga ana tjetër (e lidhur me Objektivin Strategjik 5). Ndërgjegjësimi për parandalimin e mbetjeve dhe përfitimet e tij, si dhe kultura e ripërdorimit dhe riparimit, duhet të bëhen pjesë e përditshme e bizneseve dhe e konsumatorëve.

Referuar përkufizimit në Direktivën Kuadër të Mbetjeve dhe në ligjin për MIM, "*parandalimi*" ka kuptimin: "*masat që merren përpara se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet: sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre; ndikimi negativ i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut; përmbajtja e substancave të rrezikshme në materiale dhe produkte*"

Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve parashikon një sërë masash që synojnë reduktimin e mbetjeve në burim dhe promovimin e modeleve të konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm. Në nivel vendor, Bashkia Tepelenë do të marrë në konsideratë përfshirjen e masave që nxisin ripërdorimin, riparimin dhe zgjatjen e jetës së produkteve, promovimin e kompostimit të mbetjeve organike, reduktimin e mbetjeve ushqimore, si dhe kufizimin e përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe në institucionet publike dhe bizneset lokale. Gjithashtu, mund të parashikohen masa për zbatimin gradual të praktikave të prokurimit publik të gjelbër, zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit për konsumin e qëndrueshëm dhe ekonominë qarkulluese, si dhe nisma që lehtësojnë dhurimin, shkëmbimin dhe ripërdorimin e produkteve. Në varësi të prioritetëve dhe burimeve financiare të bashkisë, këto masa mund të përshtaten dhe të integrohen në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, duke kontribuar në arritjen e objektivave kombëtare dhe evropiane për parandalimin e krijimit të mbetjeve.

4.3.1.1 Objektivi specifik 1.1: Të krijohen kushtet për ripërdorimin e produkteve dhe materialeve në nivel vendor.

Ripërdorimi i produkteve dhe materialeve përbën një nga prioritetet e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, pasi zgjat jetën e produkteve, redukton konsumin e burimeve natyrore dhe ul sasinë e mbetjeve që kërkojnë trajtim ose depozitim. Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë do të

krijojë kushtet e nevojshme infrastrukturore dhe institucionale për të nxitur ripërdorimin, përmes zhvillimit të partneriteteve me sektorin publik, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset private.

Bashkia Tepelenë do të krijojë një Park Ekologjik, i cili do të funksionojë si një qendër e dedikuar për grumbullimin, ndarjen dhe ripërdorimin e mbetjeve voluminoze. Në këtë qendër qytetarët do të mund të dorëzojnë mobilje, pajisje elektroshtëpiake dhe materiale të tjera që mund të riparohen ose ripërdoren. Kjo do të reduktojë depozitimin e pakontrolluar të mbetjeve, do të rrisë ripërdorimin e produkteve dhe do të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese.

Paralelisht, parashikohen marrëveshje bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dhe organizata të tjera humanitare që mbështesin shtresat në nevojë. Këto bashkëpunime do të mundësojnë grumbullimin, selektimin dhe shpërndarjen e veshjeve dhe tekstileve të përdorshme, duke u dhënë një jetë të dytë këtyre materialeve dhe duke kontribuar njëkohësisht në ndihmën sociale për familjet në vështirësi ekonomike.

Gjithashtu, Bashkia do të identifikojë mundësitë për partneritet me sektorin privat në fushën e trajtimit dhe ripërdorimit të mbetjeve inerte. Kjo përfshin identifikimin e kompanive të interesuara për riciklimin e materialeve të ndërtimit si betoni, tullat dhe dherat, si dhe zhvillimin e modeleve bashkëpunuese që mundësojnë përpunimin dhe rikthimin e tyre në përdorim. Një qasje e tillë do të ndihmojë në uljen e ndotjes, kursimin e burimeve natyrore dhe krijimin e një sistemi më efikas dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal.

Zbatimi i këtij objekti do të krijojë bazat për zhvillimin e sistemeve lokale të ripërdorimit, do të reduktojë sasinë e mbetjeve që dërgohen për depozitim, do të nxisë ekonominë qarkulluese dhe do të forcojë bashkëpunimin ndërmjet bashkisë, komunitetit, organizatave dhe sektorit privat.

Masat:

- M 1.1.1 Krijimi i Parkut Ekologjik për dorëzimin e mbetjeve voluminoze ku mund të lehtësohet ripërdorimi*
- M 1.1.2 Marrëveshje bashkëpunimi me organizata që ofrojnë mbështetje për shtresat në nevojë për ripërdorimin e veshjeve*
- M 1.1.3 Identifikimi i mundësive për investim dhe partneritet me sektorin privat për ripërdorimin e mbetjeve inerte*

4.3.1.2 Objekti specifik 1.2: Të zvogëlohet gjenerimi i mbetjeve në burim, përmes zbatimit të masave të parandalimit, promovimit të ripërdorimit dhe nxitjes së modeleve të konsumit të qëndrueshëm

Ky objektiv synon të reduktojë gjenerimin e mbetjeve në burim, në përputhje me hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, duke promovuar modele të konsumit të qëndrueshëm dhe praktika që zgjasin jetën e produkteve. Për Bashkinë Tepelenë, parandalimi i krijimit të mbetjeve përbën një nga instrumentet më efektive dhe me kosto më të ulët për uljen e sasisë së mbetjeve që kërkojnë grumbullim, transport dhe depozitim, si dhe për reduktimin e ndikimeve në mjedis.

Karakteristikë kryesore rurale është bashkisë, prania e një numri të madh familjesh me aktivitet bujqësor, zhvillimi gradual i turizmit dhe dominimi i bizneseve të vogla krijojnë mundësi të favorshme për zbatimin e masave të parandalimit. Në këtë kuadër, objekti parashikon hartimin dhe zbatimin e një Programi Vendor për Parandalimin e Mbetjeve, i cili do të përcaktojë prioritetet, masat konkrete, përgjegjësitë institucionale dhe mekanizmat e monitorimit për reduktimin e mbetjeve në burim. Programi do të orientojë zbatimin e masave prioritare në përputhje me karakteristikat

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

territoriale, ekonomike dhe sociale të bashkisë sonë, duke siguruar koordinimin ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe komunitetit.

Në zbatim të Programit Vendor për Parandalimin e Mbetjeve, Bashkia do të zhvillojë një paketë të integruar masash edukative, ndërgjegjësuere dhe praktike, të orientuara drejt ndryshimit të sjelljes së qytetarëve, institucioneve dhe bizneseve. Këto masa do të përfshijnë fushata informuese për reduktimin e mbetjeve ushqimore dhe konsumin e qëndrueshëm, promovimin e alternativave të ripërdorshme në vend të produkteve plastike njëpërdorimshe, nisma për ripërdorimin dhe shkëmbimin e produkteve të përdorshme, zhvillimin e aktiviteteve edukative në shkolla dhe komunitet mbi hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe ekonominë qarkulluese, si dhe projekte pilot për kompostimin në burim, veçanërisht në zonat rurale. Në bashkëpunim me institucionet arsimore, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile do të promovohen gjithashtu iniciativa praktike, si panaire të ripërdorimit, punëtori krijuese, klube ekologjike, aktivitete komunitare dhe projekte demonstrative, me synim forcimin e kulturës së parandalimit të mbetjeve dhe përdorimit efikas të burimeve.

Fushatat do të bazohen në mesazhe të thjeshta dhe të përshtatura për grupet e synuara, të orientuara drejt reduktimit të mbetjeve ushqimore dhe konsumit të përgjegjshëm.

Zbatimi i këtyre masave pritet të kontribuojë në uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara, rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe krijimin e një kulture të konsumit të qëndrueshëm, duke mbështetur njëkohësisht objektivat kombëtare dhe evropiane për përdorimin efikas të burimeve dhe tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese.

Masat:

M 1.2.1 Hartimi dhe zbatimi i një Programi Vendor për Parandalimin e Mbetjeve

M 1.2.2 Zbatimi i fushatave dhe programeve edukative për promovimin e konsumit të qëndrueshëm, reduktimin e mbetjeve ushqimore dhe zëvendësimin e produkteve njëpërdorimshe

M 1.2.3 Zhvillimi i nismave praktike për ripërdorimin, kompostimin në burim dhe ekonominë qarkulluese në shkolla, institucione, biznese dhe komunitet.

4.3.2 Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Bashkia Tepelenë synon të zhvillojë një sistem modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, i cili garanton mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe ruajtjen e pasurive natyrore të territorit. Në përputhje me hierarkinë e mbetjeve, prioritet do t'i jepet ndarjes në burim, ripërdorimit, riciklimit dhe trajtimit të kontrolluar të mbetjeve, duke minimizuar depozitimin dhe ndikimet negative në mjedis.

Përmes këtij objekti, bashkia synon të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve ekzistuese, të zgjerojë mbulimin në të gjithë territorin administrativ, të forcojë menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve dhe të eliminojë gradualisht praktikën që cenojnë mjedisin. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së lumit Vjosë dhe zonave me vlera të larta natyrore e turistike, si dhe zhvillimit të partneriteteve me komunitetin, sektorin privat dhe shoqërinë civile për të ndërtuar një sistem të integruar, efikas dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të menaxhimit të mbetjeve.

4.3.2.1 Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në zonat ekzistuese dhe shtrirja e tij në të gjithë territorin administrativ të bashkisë

Zhvillimi dhe zgjerimi i sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve do të realizohet në mënyrë graduale, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe parimet e qëndrueshmërisë financiare, duke garantuar njëkohësisht përballueshmërinë e shërbimit për qytetarët dhe bashkinë.

Në kuadër të përmirësimit dhe të zgjerimit të shërbimit, Bashkia Tepelenë synon që brenda vitit 2026 të shtojë mjetet për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Mjetet e reja do të shërbejnë si për zëvendësimin e mjeteve ekzistuese gjatë rasteve të defekteve apo periudhave të mirëmbajtjes, ashtu edhe për rritjen e kapaciteteve operacionale të sistemit. Konkretisht, planifikohet shtimi i flotës së mjeteve të grumbullimit me 4 kamionë të rinj, prej të cilëve 3 kamionë me kapacitet mbajtës 10 ton dhe 1 kamion me kapacitet 5 ton, të cilët pritet të ndikojnë ndjeshëm në rritjen e efijencës dhe cilësisë së shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.

Mbulimi i plotë i territorit të Bashkisë Tepelenë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve përbën një element thelbësor për garantimin e barazisë së qytetarëve për të përfituar nga shërbimet publike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit. Zgjerimi i mbulimit me shërbim në zonat e largëta rurale merr një rëndësi të veçantë sociale dhe mjedisore, veçanërisht për ruajtjen e vlerave natyrore dhe peizazhit të bashkisë, që lidhen ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe potencialin turistik të territorit. Mbulimi i plotë i territorit me shërbim parashikohet të arrihet brenda dy vjetësh nga miratimi i këtij Plani.

Shtrirja e shërbimit në lagjet Lekël dhe Kordhaj, si edhe në zonën e sipërme të Mezhgoranit dhe në Dorëz, do të realizohet nëpërmjet vendosjes së kontenierëve shtesë dhe organizimit të itinerareve përkatëse të grumbullimit. Kjo ndërhyrje do të kontribuojë në reduktimin e depozitimit të pakontrolluar të mbetjeve, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe shëndetit publik, si dhe garantimin e aksesit të barabartë të qytetarëve në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Njëkohësisht, ofrimi i një shërbimi të rregullt dhe cilësor për të gjithë banorët e bashkisë forcon besimin e qytetarëve ndaj institucioneve vendore dhe rrit përgjegjësinë e tyre për respektimin e rregullave të menaxhimit të mbetjeve.

Bashkia Tepelenë do të kryejë një vlerësim të pikave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve për të identifikuar vendndodhjet që kërkojnë sistemim ose ndërtimin e platformave të dedikuara. Kjo ndërhyrje synon të përmirësojë funksionalitetin e pikave të grumbullimit, të garantojë aksesin e përshtatshëm për përdoruesit dhe mjetet e shërbimit, si dhe të shmangë zhvendosjen e pakontrolluar të kontenierëve. Pas përcaktimit të vendndodhjeve përfundimtare, pikat e grumbullimit do të miratohen nga Këshilli Bashkiak dhe do të pasqyrohen në dokumentacionin përkatës të bashkisë. Në vijim, do të zhvillohet një proces informimi dhe ndërgjegjësimi për qytetarët mbi vendndodhjet zyrtare të kontenierëve dhe mënyrën e përdorimit të tyre, me synim rritjen e efikasitetit të shërbimit dhe përmirësimin e pastërtisë në hapësirat publike.

Për të garantuar standardet teknike, sigurinë dhe standardet higjieno-sanitare të sistemit, do të zbatohet një program periodik i mirëmbajtjes së kontenierëve. Ky program do të përfshijë pastrimin dhe dezinfektimin e tyre, kontrollin teknik të gjendjes fizike, si edhe kryerjen e riparimeve të nevojshme në rast dëmtimesh të rrotave, kapakëve, mekanizmave të ngritjes apo strukturës mbajtëse. Parashikohet edhe rinovimi periodik i kontenierëve ekzistues: konkretisht, çdo vit do të zëvendësohet rreth 10% e kontenierëve metalikë me kapacitet 1.6 m³ dhe rreth 15% e kontenierëve plastikë me kapacitet 1.1 m³. Ky proces do të kontribuojë në ruajtjen e

cilësisë së infrastrukturës së grumbullimit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit ndaj qytetarëve.

Bashkia do të monitorojë periodikisht mbulimin e territorit me shërbim, gjendjen e infrastrukturës së grumbullimit, frekuencën e ofrit të shërbimit dhe ankesat e qytetarëve, me qëllim identifikimin në kohë të nevojave për përmirësim dhe garantimin e standardeve të përcaktuara në këtë plan.

Masat:

- M 2.1.1 Përforcimi i flotës së mjeteve për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe zgjerimin e mbulimit në të gjithë territorin e bashkisë.*
- M 2.1.2 Shtimi i mbulimit të territorit me kontenierë në Lekël, Kordhaj, Lagjja e Sipërme e Mezhgoranit dhe Dorëz*
- M 2.1.3 Miratimi i vendndodhjes së kontenierëve në Këshill Bashkiak*
- M 2.1.4 Shpërndarja e informacionit për publikun për pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) të miratuara*
- M 2.1.5 Identifikimi i vend-vendosjes së kontenierëve që kanë nevojë për sistemimin e vendit ose platformë*
- M 2.1.6 Sistemimi i vendit ose ndërtimi i platformave në pikat e grumbullimit të mbetjeve sipas nevojës*
- M 2.1.7 Mirëmbajtja dhe riparimi i kontenierëve*
- M 2.1.8 Zëvendësimi periodik i kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve*
- M 2.1.9 Larja dhe higjienizimi i kontenierëve të mbetjeve*

4.3.2.2 Objektivi specifik 2.2: Ndarja në burim dhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme

Aktualisht, riciklimi në territorin e Bashkisë Tepelenë zhvillohet në nivele të kufizuara dhe nuk ekziston një sistem i organizuar i ndarjes në burim. Për këtë arsye, bashkia do të zbatojë gradualisht një model lokal të grumbullimit të veçuar të plastikës dhe kartonit, duke filluar nga institucionet publike, bizneset me potencial më të lartë gjenerimi dhe zonat urbane me dendësi më të madhe të popullsisë.

Synimi i bashkisë është që deri në fund të periudhës së planit të krijojë një sistem funksional të ndarjes në burim për plastikën dhe kartonin në institucionet publike, bizneset kryesore dhe zonat urbane, duke rritur gradualisht sasinë e materialeve të riciklueshme të grumbulluara veçmas dhe të dërguara për riciklim. Për të arritur objektivat e riciklimit të materialeve nga mbetjet, është thelbësore përfshirja aktive e qytetarëve, institucioneve dhe bizneseve në ndarjen e mbetjeve në burim. Në këtë kuadër, Bashkia Tepelenë propozon zbatimin e një projekti pilot në qendër të qytetit, si fazë e parë për zhvillimin e sistemit të riciklimit dhe identifikimin e strategjisë më efektive të grumbullimit të diferencuar. Projekti parashikon dizenjimin, prodhimin dhe vendosjen e kontenierëve specifikë për grumbullimin e materialeve të riciklueshme, fillimisht për plastikën dhe letrën/kartonin, në zonat më të dukshme dhe më të frekuentuara të qytetit, veçanërisht në

zonën pedonale dhe sheshin kryesor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës. Kontenierët do të shoqërohen me sinjalistikë informuese dhe fushata ndërgjegjësimi për qytetarët, me synim rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në ndarjen e mbetjeve në burim dhe promovimin e praktikave të riciklimit.

Kjo qasje mbështet zbatimin gradual të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe objektivat kombëtare për rritjen e riciklimit dhe reduktimin e depozitimit të mbetjeve.



Figura 13 Shembull i koshave të ndarë për materialet e riciklueshme (foto majtas, bashkia Tiranë)

Në kuadër të edukimit mjedisor dhe rritjes së praktikave të riciklimit, bashkia do të përcaktojë institucionet publike që do të përfshihen në skemën e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, duke përfshirë vetë bashkinë, dy shkolla 9-vjeçare, një shkollë të mesme dhe një kopsht. Për secilin institucion do të planifikohet infrastruktura e nevojshme me kontenierë dhe mënyra e organizimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të riciklueshme.

Në vijim, Bashkia Tepelenë synon të shtrijë sistemin e grumbullimit të materialeve të riciklueshme në të gjithë territorin e zonës urbane, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme dhe organizimin e frekuencës së grumbullimit të diferencuar për materialet e riciklueshme. Sistemi do të zbatohet paralelisht me fushata ndërgjegjësimi dhe informimi për qytetarët dhe bizneset, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në ndarjen e mbetjeve në burim. Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme planifikohet të realizohet një herë në javë, nëpërmjet një itinerari të dedikuar, duke përdorur kapacitetet ekzistuese të ndërmarrjes së shërbimeve.

Paralelisht, do të vendosen kontenierë të dedikuar për grumbullimin e kartonit pranë bizneseve që gjenerojnë sasi të konsiderueshme të mbetjeve të ambalazhit, si marketet, njësi të ndryshme tregtare, dyqanet e luleve, shërbimet e hoteleri-turizmit, etj. Për këto biznese do të hartohen marrëveshje bashkëpunimi që do të përcaktojnë detyrimet për ndarjen në burim dhe përdorimin e kontenierëve të dedikuar. Gjithashtu, bashkia do të shqyrtojë vendosjen e mekanizmave tariforë që nxisin menaxhimin e veçuar të kartonit dhe dekurajojnë përdorimin e kapaciteteve publike të grumbullimit për sasi të mëdha mbetjesh ambalazhi të gjeneruara nga aktivitetet ekonomike.

Për të mbështetur zhvillimin e sistemit të ndarjes në burim dhe përgatitjen e materialeve për riciklim, Bashkia Tepelenë do të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe ngritjes së një qendre burimore për grumbullimin, seleksionimin dhe depozitimin e përkohshëm të materialeve të riciklueshme, kryesisht kartonit dhe plastikës. Kjo qendër do të shërbejë si një pikë ndërmjetëse për konsolidimin e materialeve të grumbulluara, duke mundësuar trajtimin më efikas të tyre dhe krijimin e sasive të mjaftueshme për transferim drejt operatorëve të riciklimit. Ngritja e qendrës burimore do të vlerësohet në varësi të sasive të materialeve të riciklueshme të grumbulluara dhe fizibilitetit teknik e ekonomik të investimit.

Për të siguruar funksionimin e plotë të zinxhirit të riciklimit, bashkia do të identifikojë dhe vlerësojë mundësitë e bashkëpunimit me operatorë privatë të licencuar që ushtrojnë aktivitet në fushën e grumbullimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve. Në këtë kuadër, synohet nënshkrimi i të paktën një marrëveshjeje bashkëpunimi për marrjen dhe trajtimin e materialeve të riciklueshme të grumbulluara në territorin e bashkisë.

Njëkohësisht, do të vlerësohen modele alternative për valorizimin ekonomik të këtyre materialeve, përfshirë mundësinë e shitjes së tyre përmes procedurave transparente dhe konkurruese, bazuar në kushtet dhe çmimet e tregut. Kjo qasje synon të kontribuojë në qëndrueshmërinë financiare të sistemit dhe në promovimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese në nivel vendor.

Këto masa do të krijojnë kushtet për zhvillimin gradual të ekonomisë qarkulluese në nivel lokal, duke mundësuar rikthimin e materialeve të riciklueshme në zinxhirin ekonomik dhe duke reduktuar sasinë e mbetjeve që dërgohen për depozitim. Deri në fund të periudhës së planit, bashkia synon të ketë funksional një sistem të grumbullimit të diferencuar të plastikës dhe letrës/kartonit në institucionet publike, bizneset kryesore dhe në zonën urbane të qytetit të Tepelenës.

Zgjerimi i ndarjes në burim dhe rritja e riciklimit kontribuojnë njëkohësisht në reduktimin e sasisë së mbetjeve të depozituara, uljen e emetimeve të gazeve serrë dhe kursimin e burimeve natyrore.



Figura 14 Shembull i grumbullimit të kartonit pranë subjekteve tregtare

Masat:

- M 2.2.1 Dizenjimi, prodhimi dhe vendosja e kontenerëve specifikë për grumbullimin e shisheve plastike në zonën pedonale të qytetit.*
- M 2.2.2 Përcaktimi i institucioneve dhe skemës së grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme në to dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme*
- M 2.2.3 Vendosja e kontenerëve specifikë për kartonin në bizneset që gjenerojnë sasinë më të madhe të ambalazhit karton*
- M 2.2.4 Ngritja e sistemit të grumbullimit të diferencuar të plastikës dhe kartonit, përmes*

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

përdorimit të qeseve dhe një itinerari të veçantë të grumbullimit, shoqëruar me fushatë ndërgjegjësimi

M 2.2.5 Planifikimi dhe ngritja e qendrës burimore për seleksionimin dhe depozitimin e përkohshëm të materialeve të riciklueshme (karton dhe plastikë)

M 2.2.6 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset për ndarjen në burim të kartonit dhe përcaktimi i mekanizmave tariforë që shmangin përdorimin e tepruar të kontenerëve publikë për mbetje ambalazhi

M 2.2.7 Nënshkrimi i marrëveshjeve me operatorë të liçencuar për marrjen dhe riciklimin e materialeve të grumbulluara veçmas

4.3.2.3 Objektivi specifik 2.3: Reduktimi i depozitimit në landfill të mbetjeve të biodegradueshme

Reduktimi i mbetjeve të biodegradueshme përbën një nga prioritetet kryesore të këtij plani, pasi ky fraksion përfaqëson pjesën më të madhe të mbetjeve bashkiake në Tepelenë dhe është ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e kostove të transportit dhe depozitimit. Devijimi i mbetjeve organike nga depozitimi jo vetëm që ul sasinë e mbetjeve që dërgohen në venddepozitim, por kontribuon edhe në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe rikthimin e lëndës organike në tokë nëpërmjet kompostimit.

Ky objektivi plotëson masat e Objektivit Strategjik 1 për parandalimin e krijimit të mbetjeve, duke promovuar kompostimin në burim dhe trajtimin e mbetjeve organike pranë vendit të gjenerimit. Në këtë mënyrë, një pjesë e mbetjeve nuk hyn fare në sistemin e grumbullimit dhe transportit, duke reduktuar kostot e shërbimit dhe ndikimin mjedisor.

Analiza e mbetjeve tregon se më shumë se 60% e mbetjeve bashkiake janë organike. Në zonat rurale të Tepelenës, ku një pjesë e konsiderueshme e familjeve disponojnë oborre, toka bujqësore ose aktivitete blegtorale, kompostimi në familje paraqet një alternativë me kosto të ulët dhe me potencial të lartë për reduktimin e mbetjeve organike dhe për prodhimin e plehut natyror për përdorim lokal. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve kërkon reduktimin e sasisë së mbetjeve bio që depozitohen në vend depozitime, ndaj parashikohet edhe grumbullimi i veçuar i mbetjeve organike urbane dhe kompostimi i tyre, për të përmbushur kërkesat ligjore (në masën 55% deri në 2030).

Arritja e këtij objektivi varet në masë të madhe nga ndryshimi i sjelljes së qytetarëve dhe fermerëve. Për këtë arsye, masat e parashikuara do të mbështeten nga aktivitetet e edukimit dhe ndërgjegjësimit të Objektivit Strategjik 5, përmes demonstrimeve praktike, materialeve informuese, aktiviteteve në shkollë dhe promovimit të modeleve të suksesshme lokale të kompostimit.

Promovimi i praktikave të qëndrueshme në zonat rurale synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjen aktive të banorëve në grumbullimin dhe trajtimin në familje të mbetjeve të gjelbra. Kjo realizohet përmes shpërndarjes së historive të suksesshme nga fshatra të përzgjedhur pilot, si p.sh. fshati Sinanaj, i cili shërben si model për praktikën e mira në menaxhimin e mbetjeve organike. Kompostimi në shtëpi është një praktikë që duhet të nxitet për zonat rurale, ku banorët mund të copëtojnë mbetjet e gjelbra që gjenerojnë dhe të prodhojnë kompost për përdorim vetjak në kopshtet e tyre.



Figura 16 Mënyrë kompostimi për mbetjet e gjelbra në kopshtet e shtëpive (foto, KRËM SHA, Landfill Maliq)



Figura 15 Shembull i grumbullimit të mbetjeve të jashtëqitjeve të bagëtive dhe kafshëve

Parashikohet monitorimi i vazhdueshëm i fushave apo pikave ku Bashkia aktualisht grumbullon mbetjet e krasitjeve dhe mbetjet e tjera të gjelbra. Këto mbetje duhet të grumbullohen në mënyrë të ndarë dhe të pastër, duke shmangur përzierjen me mbetje të tjera urbane, me qëllim rritjen e mundësive për kompostim dhe trajtim të mëtejshëm.

Në çdo fshat parashikohet përcaktimi i pikave të posaçme për grumbullimin e mbetjeve të bagëtive, në bashkëpunim dhe me dakordësinë e kryesisë së fshatit. Banorët do të informohen dhe sensibilizohen përmes kryetarëve të fshatrave dhe strukturave të komunitetit, duke siguruar pjesëmarrje dhe zbatim efektiv të masave të propozuara. Kjo qasje synon reduktimin e ndotjes dhe menaxhimin më të mirë të mbetjeve blegtorale në nivel lokal.

Masat:

- M 2.3.1 Promovimi i praktikës për grumbullimin dhe trajtimin në familje të mbetjeve të gjelbra*
- M 2.3.2 Monitorimi i fushës ku bashkia / ndërmarrja grumbullon mbetjet e krasitjeve, të pastra të grumbulluara veçmas*
- M 2.3.3 Përcaktimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve të jashtëqitjeve të bagëtive dhe kafshëve në çdo fshat me dakordësi të kryesisë së fshatit*

4.3.2.4 Objektivi specifik 2.4: Menaxhimi i integruar e mjedisor i mbetjeve inerte nga ndërtimet dhe prishja e objekteve

Në Bashkinë Tepelenë do të vazhdojë të jetë në përdorim venddepozitimi i mbetjeve inerte, i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 5, datë 31.01.2024 në afërsi të fshatit Luzat, pranë rrugës nacionale Tepelenë-Gjirokastrë.

Aktiviteti i dorëzimit të mbetjeve inerte do të bëhet në përputhje me kërkesat e VKM nr 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Për të parandaluar depozitimin e mbetjeve inerte pranë kontenerëve dhe hedhjen e materialeve të papërshtatshme në venddepozitimin e miratuar me VKB, Bashkia Tepelenë do të zbatojë një sërë masash administrative dhe monitoruese. Nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të rregullores së operimit të venddepozitimit do të përcaktohen qartë fraksionet e mbetjeve që pranojnë të dorëzohen, si edhe ndalimi i depozitimit të materialeve si plastmasi, qeset dhe mbetje të tjera

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

paketimi. Afishimi i rregullores dhe tabelave informuese pranë venddepozitimit do të shërbejë për orientimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe subjekteve ndërtimore mbi mënyrën e duhur të depozitimit.

Gjithashtu, mbajtja e një baze të dhënash për monitorimin e depozitimeve do të ndihmojë në rritjen e kontrollit dhe mundësisë për të gjurmuar mbetjet inerte, duke kontribuar në parandalimin e depozitimeve të papërshtatshme dhe përmirësimin e administrimit të venddepozitimit të mbetjeve inerte.

Masat:

M 2.4.1 Krijimi dhe zbatimi i një sistemi të kontrollit dhe monitorimit të depozitimit të mbetjeve inerte, duke përfshirë procedura të qarta për dorëzimin në venddepozitimin e miratuar dhe inspektime periodike për parandalimin e depozitimeve të paligjshme.

M 2.4.2 Mbajtja e bazës së të dhënave për depozitimet e mbetjeve inerte në venddepozitimin e përcaktuar nga bashkia

4.3.2.5 Objektivi specifik 2.5: Të përmirësohet cilësia dhe efikasiteti i shërbimit të pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike

Optimizimi i itinerareve dhe frekuencës së pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike do të realizohet përmes rishikimit të organizimit të shërbimit, duke përcaktuar itinerare dhe frekuenca të diferencuara sipas karakteristikave të zonave, densitetit të popullsisë, intensitetit të përdorimit të hapësirave publike dhe sezonalitetit. Kjo qasje do të mundësojë një përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe mjeteve ekzistuese, duke përmirësuar mbulimin dhe cilësinë e shërbimit, si dhe duke siguruar një nivel më të lartë pastërtie në zonat me prioritet.

Krijimi dhe zbatimi i një sistemi për monitorimin e performancës së shërbimit të pastrimit do të mundësojë vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe efektivitetit të shërbimit nëpërmjet indikatorëve të matshëm të performancës. Monitorimi periodik i realizimit të itinerareve, respektimit të frekuencës së planifikuar, sipërfaqeve të mirëmbajtura dhe ankesave të qytetarëve do të shërbejë si bazë për identifikimin e problematikave dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese, duke nxitur një menaxhim më transparent dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit.

Masat:

M 2.5.1. Optimizimi i itinerareve dhe frekuencës së pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike.

M 2.5.2 Vendorsja dhe zbatimi i një sistemi monitorimi të performancës së shërbimit të pastrimit

4.3.2.6 Objektivi specifik 2.6: Menaxhimi i mbetjeve specifike (voluminoze, të rrezikshme shtëpiake, mbetje të pajisjeve elektrike dhe elektronike)

Ky objektivi plotëson Objektivin Strategjik 1 për parandalimin e mbetjeve, duke nxitur ripërdorimin e produkteve dhe trajtimin e veçuar të rrymave specifike të mbetjeve, të cilat nuk

duhet të përzihen me mbetjet bashkiake. Aktualisht, në Bashkinë Tepelenë nuk ekziston një sistem i organizuar për grumbullimin e mbetjeve voluminoze, mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE), si edhe mbetjeve të rrezikshme shtëpiake. Për pasojë, këto rryma mbetjesh shpesh depozitohen pranë kontenierëve publikë ose përzihen me mbetjet urbane, duke krijuar probleme mjedisore, vështirësi në grumbullim dhe humbje të materialeve që mund të rikuperohen.

Mbetjet industriale të rrezikshme janë përgjegjësi e prodhuesit, ndërsa mbetjet mjekësore menaxhohen nga gjeneruesit e tyre nëpërmjet kontratave me operatorë të licencuar për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e tyre. Për këto rryma, Bashkia Tepelenë do të vijojë të ushtrojë rolin e monitorimit dhe kontrollit, në përputhje me kompetencat e saj.

Menaxhimi i mbetjeve industriale të rrezikshme në territor është përgjegjësi e prodhuesit. Gjithashtu, menaxhimi i mbetjeve mjekësore, kryhet nga gjeneruesit e mbetjeve me kontratë të lidhur me sipërmarrje të licencuara për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve mjekësore. Për rrjedhojë, bashkia do të vazhdojë të kryerjë për këto rryma rol monitorues.

Për mbetjet voluminoze, MPEE dhe rryma të tjera specifike të mbetjeve bashkiake, Bashkia Tepelenë do të hartojë dhe zbatojë skema të organizuara për grumbullimin e veçuar dhe dorëzimin në pika të autorizuara në bashkëpunim me distributorët dhe subjektet që vendosin këto pajisje në treg, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Në bashkëpunim me operatorët e licencuar dhe organizatat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, Bashkia do të organizojë në mënyrë periodike ditë të dedikuara ose fushata sezonale për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme shtëpiake, si bateritë, llambat, bojërat, solucionet dhe mbetje të tjera të ngjashme, me qëllim shmangien e përzierjes së tyre me mbetjet bashkiake.

Zbatimi i këtij objekti do të mbështetet nga aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimin të Objektivit Strategjik 5, përmes informimit të qytetarëve mbi mënyrën dhe vendet e dorëzimit të këtyre mbetjeve.

Nëpërmjet këtyre masave, Bashkia Tepelenë synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve, duke reduktuar depozitimin e tyre të pakontrolluar pranë kontenierëve publikë, duke rritur mundësitë për ripërdorim dhe riciklim, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Masat:

- M 2.6.1. *Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me distributorët dhe subjektet përgjegjëse për organizimin e grumbullimit të MPEE.*
- M 2.6.2 *Krijimi i një skeme për dorëzimin, riparimin dhe ripërdorimin e mobiljeve dhe pajisjeve të përdorshme në bashkëpunim me organizata sociale dhe subjekte private.*

4.3.2.7 Objekti specifik 2.7: Mbyllja e sigurt dhe me standard e venddepozitimeve dhe pastrimi i pikave të paligjshme

Objekti i këtij kapitulli është eliminimi gradual i praktikave të depozitimit të pakontrolluar të mbetjeve dhe rehabilitimi i zonave të ndotura, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe objektivat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Mbyllja e venddepozitimeve ekzistuese dhe rehabilitimi i tyre përbëjnë një hap të domosdoshëm për mbrojtjen e mjedisit, burimeve ujore dhe shëndetit publik, si edhe për përmirësimin e imazhit turistik të Bashkisë Tepelenë.

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Parashikohet zbatimi i një sërë masash për përmirësimin e gjendjes mjedisore në territorin e bashkisë. Këto masa përfshijnë pastrimin e zonave të ndotura, duke përfshirë shtratin e përrenjve dhe Kanionin e Bëncës; mbylljen dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese në Sinanaj dhe Dashaj; si edhe forcimin e masave parandaluese kundër krijimit të vendgrumbullimeve të reja, përmes informimit të qytetarëve dhe zbatimit të masave ndëshkimore ndaj hedhjeve të paligjshme.

Mbyllja e venddepozitimit të Tepelenës do të realizohet në përputhje me kërkesat teknike të VKM nr. 452, datë 11.07.2012, i ndryshuar, "Për landfillet e mbetjeve", i cili përcakton procedurat dhe standardet për mbylljen, rehabilitimin dhe monitorimin pas mbylljes së venddepozitimeve, me qëllim mbrojtjen e ujërave, tokës, ajrit dhe shëndetit të njeriut.

Venddepozitimi i Majkoshit ndodhet në një distancë shumë të vogël nga shtrati i lumit të Vjosës, çka përbën një rrezik të konsiderueshëm për mjedisin dhe burimet ujore të zonës. Duke qenë se distanca nga lumi është më e vogël se 100 metra, mbetjet e depozituara në këtë venddepozitim krijojnë problematika serioze, veçanërisht për shkak të liksivateve që gjenerohen nga dekompozimi i mbetjeve.

Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë do të ndërmarrë masa të menjëhershme për mbylljen graduale të venddepozitimit të Majkoshit dhe ndalimin e depozitimit të mëtejshëm të mbetjeve në këtë zonë. Si masë tranzitore, propozohet që mbetjet urbane të Bashkisë Tepelenë të transportohen dhe të depozitohen në landfillin e Bajkajt, i cili ofron kushte më të kontrolluara dhe më të sigurta për trajtimin e mbetjeve. Kjo zgjidhje duhet të zbatohet deri në përcaktimin e vendndodhjes së përshtatshme dhe ndërtimin e stacionit të transferimit, i cili do të mundësojë optimizimin e transportit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Paralelisht me mbylljen e venddepozitimit, është e nevojshme të hartohen dhe zbatohen masa rehabilituese për zonën ekzistuese, duke përfshirë mbulimin e mbetjeve, kontrollin e rrjedhjes së liksivateve dhe monitorimin mjedisor të zonës përreth. Pas stabilizimit të trupit të mbetjeve, bashkia do të vlerësojë edhe rehabilitimin ekologjik të zonës përmes mbulimit me shtresë vegjetale dhe gjelbërimit, në përputhje me kushtet teknike dhe mjedisore. Këto masa janë të domosdoshme për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis dhe për të mbrojtur lumin Vjosë, i cili përfaqëson një nga pasuritë natyrore më të rëndësishme të rajonit.

Pas mbylljes së venddepozitimit, Bashkia do të sigurojë monitorimin periodik të gjendjes së zonës, në përputhje me kërkesat ligjore, duke ndjekur stabilitetin e trupit të mbetjeve, gjendjen e mbulesës përfundimtare, praninë e rrjedhjeve të mundshme të liksivateve dhe ndikimin në mjedisin përreth.

Arritja e këtij objektiivi lidhet ngushtë me Objektivin 2.1 për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit, Objektivin 2.2 për ndarjen në burim dhe Objektivin 2.3 për reduktimin e mbetjeve të biodegradueshme, pasi sa më pak mbetje të depozitohen në mënyrë të pakontrolluar dhe sa më shumë materiale të devijohen drejt riciklimit ose kompostimit, aq më i qëndrueshëm bëhet procesi i mbylljes së venddepozitimeve ekzistuese. Nëpërmjet këtyre masave, Bashkia Tepelenë synon të eliminojë gradualisht praktikatat e depozitimit të pakontrolluar të mbetjeve, të rehabilitojë zonat e ndotura dhe të sigurojë që të gjitha mbetjet bashkiake të trajtohen në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane. Zbatimi i këtij objektiivi do të kontribuojë drejtpërdrejt në mbrojtjen e lumit Vjosë, përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe forcimin e potencialit turistik e natyror të territorit.

Masat:

M 2.7.1 Pastrimi i shtratit të përrenjve nga mbetjet e depozituara

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

M 2.7.2 Pastrimi i kanionit në Bënçë nga mbetjet

M 2.7.3 Njoftime për masa ndëshkimore për hedhjet e paligjshme

M 2.7.4 Mbyllja dhe pastrimi i venddepozitimeve në Sinanaj dhe Dashaj

M 2.7.5 Mbyllja e venddepozitimit në Majkosh

M 2.7.6 Monitorimi mjedisor pas mbylljes së venddepozitimit të Majkoshit, në përputhje me kërkesat ligjore.

4.3.3 Objektivi strategjik 3: Forcimi i kapaciteteve institucionale, administrative dhe teknike të Bashkisë Tepelenë për menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve dhe zhvillimi i kuadrit rregullator në përputhje me legjislacionin.

Ofrimi i një shërbimi modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të integruar dhe mjedisor të mbetjeve kërkon jo vetëm investime në infrastrukturë dhe pajisje, por edhe struktura administrative funksionale, burime njerëzore të kualifikuara, procedura të standardizuara pune dhe një kuadër rregullator të përditësuar. Forcimi i kapaciteteve institucionale përbën kushtin themelor për planifikimin, organizimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit.

Ky objektivi strategjik mbështetet në tre shtylla kryesore:

- forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit;
- përmirësimin e organizimit institucional dhe kuadrit rregullator;
- zhvillimin e sistemeve të monitorimit, raportimit dhe kontrollit të performancës.

Arritja e objektivave të Planit për parandalimin e mbetjeve, ndarjen në burim, riciklimin, reduktimin e depozitimit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit varet drejtpërdrejt nga aftësia e administratës vendore për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht shërbimin.

Zbatimi i këtij objektivi kërkon gjithashtu angazhim të vazhdueshëm institucional dhe mbështetje financiare nga organet drejtuese të bashkisë, përmes miratimit të politikave, rregulloreve, burimeve njerëzore dhe buxheteve të nevojshme për garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit.

4.3.3.1 Objektivi specifik 3.1 Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Zbatimi i objektivave të Planit kërkon staf të trajnuar dhe të aftë për të planifikuar, organizuar dhe monitoruar të gjitha komponentët e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Zgjerimi i shërbimit në të gjithë territorin, zhvillimi i ndarjes në burim, grumbullimi i diferencuar, monitorimi i kontratave dhe raportimi sipas kërkesave ligjore rrisin ndjeshëm kompleksitetin e menaxhimit të sistemit.

Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë do të zhvillojë një program të vazhdueshëm të ngritjes së kapaciteteve profesionale për stafin administrativ dhe operativ, duke përfshirë aspektet teknike, ligjore, financiare, përdorimin e indikatorëve të performancës, administrimin e të dhënave, sigurinë në punë dhe komunikimin me komunitetin.

Forcimi i kapaciteteve të stafit do të mbështesë drejtpërdrejt zbatimin e Objektivit Strategjik 2, veçanërisht për organizimin e sistemeve të ndarjes në burim, monitorimin e grumbullimit të diferencuar, menaxhimin e mbetjeve biodegradueshme dhe rrymave të veçanta të mbetjeve, si edhe Objektivin Strategjik 5 për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të edukimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit.

Masat:

- M 3.1.1 Hartimi dhe zbatimi i një plani vjetor të trajnimeve për stafin përgjegjës për MIM.*
- M 3.1.2 Trajnime periodike për punonjësit operativë mbi proceset e punës, sigurinë në punë dhe standardet teknike të ofrimit të shërbimit*
- M 3.1.3 Trajnime për stafin administrativ mbi planifikimin, monitorimin, raportimin, analizën e të dhënave dhe menaxhimin financiar të shërbimit.*
- M 3.1.4 Rritja e kapaciteteve të stafit për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të informimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit.*

4.3.3.2 Objektiv i specifik 3.2: Përmirësimi i kuadrit organizativ dhe rregullator për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Një organizim institucional i qartë dhe një kuadër rregullator i përditësuar janë parakusht për ofrimin e një shërbimi efikas dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përgjegjësitë e strukturave bashkiake, procedurat e punës dhe dokumentacioni administrativ duhet të reflektojnë zhvillimet e reja të sistemit të menaxhimit të mbetjeve dhe zgjerimin e funksioneve të bashkisë.

Në këtë kuadër, Bashkia Tepelenë do të rishikojë dhe përditësojë dokumentet organizative dhe rregullatore që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë institucionale, procedurat standarde të punës dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse.

Përditësimi i kuadrit organizativ do të krijojë bazën institucionale për zbatimin e të gjitha objektivave të Planit, duke siguruar që çdo aktivitet të mbështetet nga procedura të standardizuara dhe përgjegjësi të qarta.

Masat:

- M 3.2.1 Rishikimi dhe përditësimi i Rregullores së Brendshme të Bashkisë për funksionet e MIM.*
- M 3.2.2 Përditësimi i Rregullores së Drejtorisë së Shërbimeve me një seksion të dedikuar për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë mbetjet inerte, voluminoze dhe rrymat e veçanta.*
- M 3.2.3 Përditësimi i përshkrimeve të punës për punonjësit përgjegjës për MIM*
- M 3.2.4 Hartimi dhe miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për organizimin dhe dokumentimin e shërbimit.*

4.3.3.3 Objektiv i specifik 3.3: Përmirësimi i sistemit të monitorimit, kontrollit dhe raportimit të performancës së shërbimit.

Monitorimi sistematik i shërbimit është një element kyç për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës dhe për marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna. Aktualisht, administrimi i informacionit mbi problematikat, statistikave dhe performancën e shërbimit është i kufizuar dhe kryhet kryesisht në mënyrë manuale.

Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë do të krijojë mekanizma të standardizuar për dokumentimin e problematikave, administrimin e statistikave, monitorimin periodik të treguesve të performancës dhe raportimin sipas kërkesave të legjislacionit.

Njëkohësisht, do të forcohen mekanizmat e komunikimit me administratorët e njësive administrative, kryetarët e fshatrave dhe qytetarët, me qëllim identifikimin në kohë të problematikave dhe përmirësimin e reagimit institucional ndaj tyre.

Ky sistem monitorimi do të mbështesë gjithashtu vlerësimin periodik të progresit të këtij Plani dhe përgatitjen e raporteve vjetore mbi zbatimin e tij.

Masat:

M 3.3.1 Krijimi i një sistemi për dokumentimin dhe regjistrimin e problematikave dhe ndërhyrjeve.

M 3.3.2 Përcaktimi i treguesve të performancës dhe vlerësimi periodik i cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

M 3.3.3 Hartimi dhe zbatimi i planeve javore, mujore dhe vjetore të monitorimit të shërbimit.

M 3.3.4 Dokumentimi, administrimi dhe raportimi i statistikave për mbetjet sipas kërkesave ligjore.

M 3.3.5 Vendosja e mekanizmave të raportimit të problematikave nga administratorët e njësive administrative, kryetarët e fshatrave dhe qytetarët.

4.3.4 Objektivi strategjik 4: Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve përmes ofrimit eficient të shërbimit, duke garantuar mbulimin e kostove dhe përballueshmërinë e tarifës.

Qëndrueshmëria financiare është një nga kushtet themelore për funksionimin afatgjatë të sistemit të menaxhimit të integruar dhe mjedisor të mbetjeve. Një shërbim me standarde të larta kërkon jo vetëm investime në infrastrukturë dhe pajisje, por edhe burime financiare të qëndrueshme për mbulimin e kostove operative, mirëmbajtjen e aseteve dhe zhvillimin e investimeve të reja.

Aktualisht, kostot e shërbimit në Bashkinë Tepelenë mbulohen pjesërisht nga tarifa e pastrimit dhe pjesërisht nga subvencionimi i buxhetit të bashkisë. Për të garantuar qëndrueshmërinë financiare të sistemit, Bashkia synon të rrisë gradualisht nivelin e mbulimit të kostove nga tarifa, në përputhje me parimin "ndotësi paguan", duke ruajtur njëkohësisht përballueshmërinë për qytetarët dhe bizneset.

Ky objektivi strategjik mbështetet në dy drejtime kryesore:

- përmirësimin e politikave të tarifimit dhe rritjen graduale të mbulimit të kostove;
- modernizimin e administrimit financiar të shërbimit, përmes kostimit të saktë, digjitalizimit, transparencës dhe rritjes së normës së arkëtimit.

Arritja e këtij objektivi është e lidhur ngushtë me Objektivin Strategjik 2 për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit, pasi çdo investim në infrastrukturë, ndarje në burim, riciklim apo rehabilitim i venddepozitimeve kërkon burime financiare të qëndrueshme. Njëkohësisht, ai mbështetet në Objektivin Strategjik 3 përmes forcimit të kapaciteteve administrative dhe sistemeve të monitorimit financiar, të cilat mundësojnë administrimin efektiv të tarifës dhe vlerësimin periodik të kostove të shërbimit.

4.3.4.1 Objektiv i specifik 4.1: Mbulimi i kostos së shërbimit MIM nga tarifa për mbetjet

Një nga masat prioritare është rishikimi i sistemit aktual të tarifimit dhe aplikimi i tarifave të diferencuara sipas kategorive të përdoruesve, bazuar në përcaktimet e VKM nr. 319, datë 31.05.2018. Kjo qasje synon të krijojë një sistem më të drejtë dhe më transparent, ku tarifa reflekton më mirë nivelin e përfitimit nga shërbimi dhe potencialin për gjenerimin e mbetjeve. Zbatimi i kësaj mase do të shoqërohet me analizimin e bazës ekzistuese të klientëve, rishikimin e kategorive tarifore dhe miratimin e strukturës së re tarifore nga Këshilli Bashkiak.

Për të garantuar qëndrueshmërinë financiare të sistemit, Bashkia Tepelenë do të hartojë një plan financiar 5-vjeçar, i cili do të përcaktojë objektivat për rritjen graduale të nivelit të mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit. Plani financiar do të bazohet në analizën e kostove aktuale dhe të parashikuara të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë kostot e grumbullimit, transportit, transferimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve. Gjithashtu, do të vlerësohen investimet e nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të shërbimit. Qëllimi është që rritja e tarifave të mos realizohet menjëherë, por në mënyrë graduale, duke u dhënë qytetarëve dhe bizneseve kohën e nevojshme për t'u përshtatur me ndryshimet. Çdo ndryshim tarifar do të mbështetet në analiza financiare dhe do të miratohet nga Këshilli Bashkiak në kuadër të paketës fiskale vjetore.

Në përputhje me praktikën më të avancuar evropiane, Bashkia Tepelenë synon të testojë sistemin "Paguaj sa Hedh" (Pay As You Throë – PAYT) në zonë pilot. Ky sistem bazohet në parimin se pagesa e tarifës duhet të lidhet drejtpërdrejt me sasinë e mbetjeve të gjeneruara nga secila familje. Në fazën fillestare Bashkia do të pilotojë modele të tarifimit sipas sasisë së mbetjeve (Pay As You Throë – PAYT) në zonë ku ekzistojnë kushtet teknike për matjen ose vlerësimin e sasive të mbetjeve të gjeneruara. Pilotimi do të shërbejë për të vlerësuar fizibilitetin teknik, kostot, pranueshmërinë sociale dhe ndikimin në reduktimin e mbetjeve. Kështu, për shembull, për subjektet që gjenerojnë mbetje të ambalazheve do të përcaktohet një tarifë shtesë në rastet kur përdoret më shumë se 1/4 e kapacitetit të kontenerëve publikë. Përvoja e fituar do të përdoret për të vendosur nëse sistemi mund të zgjerohet gradualisht në pjesë të tjera të territorit të bashkisë. Përveç përmirësimit të drejtësisë në tarifim, sistemi pritet të nxisë reduktimin e mbetjeve në burim, rritjen e riciklimit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndikimin e reduktimit të mbetjeve në kostot e shërbimit.

Një ndër sfidat kryesore të financimit të shërbimit mbetet niveli i mbledhjes së tarifës. Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë do të ndërmarrë veprime për identifikimin dhe përfshirjen në sistem të të gjithë përdoruesve të shërbimit. Kjo do të realizohet përmes përditësimit të bazës së të dhënave të familjeve dhe bizneseve, koordinimit ndërmjet strukturave vendore dhe kryerjes së verifikimeve në terren. Një bazë më e plotë e tatimpaguesve do të mundësojë shpërndarje më të drejtë të kostove të shërbimit dhe rritje të të ardhurave pa qenë e nevojshme të aplikohen rritje të konsiderueshme të tarifave për ata që tashmë paguajnë rregullisht.

Përmirësimi i normës së arkëtimit të tarifës do të mbështetet gjithashtu në krijimin e stimuljeve fiskale që inkurajojnë pagesën në kohë. Bashkia do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes në

paketën fiskale të lehtësive të vogla financiare për familjet dhe bizneset që kryejnë pagesën vjetore të tarifës brenda afateve të përcaktuara. Në të njëjtën kohë, do të parashikohen penalitete për pagesat e vonuara. Kjo qasje synon të përmirësojë kulturën e pagesës, të reduktojë detyrimet e prapambetura dhe të sigurojë flukse financiare më të qëndrueshme për financimin e shërbimit.

- M 4.1.1 Tarifa të diferencuara: vendosja e tarifave bazuar në madhësinë e klientëve (numri i banorëve, sipërfaqja, numri i punonjësve), sipas VKM 319/2018, bazuar në parimin "ndotësi paguan"*
- M 4.1.2 Hartimi i planit financiar 5 vjeçar për mbulimin e kostos, bazuar në politika graduale të parimit "ndotësi paguan", të miratuara nga Këshilli i Bashkisë.*
- M 4.1.3 Sistemi "paguaj sa hedh": Pilotim në zona me shtëpi private për pagesa direkte sipas tonazhit të mbetjeve që grumbullojnë.*
- M 4.1.4 Zgjerimi i bazës së taksapaguesve: Identifikimi i klientëve që nuk paguajnë tarifën*
- M 4.1.5 Stimuj për pagesë në kohë: Vendosje në paketën fiskale të stimujve për ulje të vogël për pagesa vjetore të parapaguara; penalitete të moderuara për vonesat.*

4.3.4.2 Objektivi specifik 4.2: Ngritja e një sistemi eficient dhe transparent për kostimin e shërbimeve dhe grumbullimin e tarifës së MIM

Transparenca është një komponent thelbësor për rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike dhe përmirësimin e nivelit të pagesave. Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë duhet të publikojë periodikisht në faqen e saj zyrtare informacion të detajuar mbi kostot e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, performancën operative dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të mbledhura nga tarifën.

Ky informacion mund të përfshijë kostot e menaxhimit të mbetjeve, sasinë e mbetjeve të grumbulluara, mbulimin e territorit me shërbim, normën e arkëtimit të tarifave, investimet e realizuara dhe objektivat e arritura.

Publikimi i këtyre të dhënave krijon një marrëdhënie më të fortë mes bashkisë dhe komunitetit, pasi qytetarët mund të shohin konkretisht se pagesat e tyre përdoren për përmirësimin e shërbimit. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e gatishmërisë për të paguar tarifën dhe në reduktimin e perceptimit negativ ndaj detyrimeve vendore.

Për një administrim të suksesshëm të tarifave dhe përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave, Bashkia Tepelenë duhet të krijojë një bazë të integruar të të dhënave për të gjithë përfituesit e shërbimit.

Për familjet, baza e të dhënave duhet të ndërtohet duke identifikuar numrin e familjeve ndërsa për bizneset, databaza duhet të përfshijë kategorizimin sipas nivelit të gjenerimit të mbetjeve dhe potencialit ndotës. Bizneset që prodhojnë më shumë mbetje ose që ushtrojnë aktivitete me ndikim më të lartë mjedisor duhet të tarifohen në mënyrë proporcionale me sasinë e mbetjeve të gjeneruara. Një bazë të dhënash e përditësuar dhe e integruar do të përmirësojë ndjeshëm saktësinë e faturimit dhe do të krijojë një sistem më të drejtë tarifimi. Gjithashtu, ajo do të shërbejë si instrument i rëndësishëm për planifikimin e investimeve dhe analizimin e kërkesës për shërbime në të ardhmen.

Një ndër sfidat kryesore lidhet me nivelin e ulët të arkëtimit të tarifave të shërbimeve. Për të adresuar këtë problem, Bashkia Tepelenë duhet të investojë në digjitalizimin e procesit të faturimit dhe modernizimin e sistemit të pagesave. Digjitalizimi duhet të përfshijë gjenerimin automatik të faturave, dërgimin elektronik të njoftimeve për pagesë, integrimin me platformat online të pagesave dhe mundësinë e pagesës përmes bankave, aplikacioneve elektronike dhe pikave të autorizuar të shërbimit. Një sistem i tillë redukton kostot administrative, minimizon gabimet dhe rrit efikasitetin e menaxhimit financiar. Për më tepër, qytetarët dhe bizneset përfitojnë nga procedura më të thjeshta dhe më të shpejta për kryerjen e pagesave.

Digjitalizimi mundëson gjithashtu monitorimin në kohë reale të detyrimeve të papaguara, identifikimin e debitorëve dhe hartimin e strategjive më efektive për rritjen e normës së arkëtimit. Në afat të gjatë, kjo masë kontribuon në rritjen e të ardhurave vendore dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shërbimit.

Përmirësimi i koordinimit institucional është një element kyç për rritjen e efikasitetit të mbledhjes së tarifave. Në këtë kuadër, Bashkia Tepelenë duhet të krijojë një sistem komunikimi online ndërmjet strukturave të saj, agjentëve të mbledhjes së detyrimeve dhe Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve (ShaUK). Ky sistem duhet të mundësojë shkëmbimin e menjëhershëm të informacionit mbi faturat e lëshuara, pagesat e kryera, detyrimet e prapambetura dhe ndryshimet në databazën e klientëve. Përmes integritit të sistemeve elektronike, do të shmangen vonesat në raportim dhe mospërputhjet e të dhënave. Komunikimi në kohë reale përmirëson procesin e arkëtimit dhe krijon mundësi për ndërhyrje të shpejta në rastet kur evidentohen probleme ose mosfunksionime.

Përveç masave teknike dhe administrative, është e nevojshme të ndërmerren aktivitete të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e pagesës së tarifave të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Programi i ndërgjegjësimit duhet të synojë informimin e qytetarëve dhe bizneseve mbi lidhjen e drejtpërdrejtë midis pagesës së tarifës dhe cilësisë së shërbimit të ofruar. Fushatat mund të realizohen përmes mediave lokale, rrjeteve sociale, takimeve me komunitetin, aktiviteteve në shkolla dhe shpërndarjes së materialeve informuese. Një element i rëndësishëm është shpjegimi i kostove reale të shërbimit dhe i përfitimeve që sjell pagesa e rregullt e tarifave, si mjedis më i pastër, shërbim më cilësor, investime në infrastrukturë dhe mbrojtje më e mirë e shëndetit publik. Ndërgjegjësimi i qytetarëve ndihmon në krijimin e një kulture pagese dhe përgjegjësie qytetare duke rritur normën e arkëtimit. Në afat të gjatë, kjo masë kontribuon në qëndrueshmërinë financiare të sistemit dhe në përmirësimin e performancës së përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Tepelenë.

- M 4.2.1 Llogaritja e detajuar e kostos efijente, bazuar në VKM 319/2018 për çdo qendër kostoje.*
- M 4.2.2 Publikimi i kostove dhe performancës dhe mënyrës së përdorimit të tarifave në faqen web të bashkisë*
- M 4.2.3 Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për klientët që përfitojnë shërbim: Për familjet sipas Regjistrit civil dhe bizneset të kategorizuara sipas ndotjes.*
- M 4.2.4 Digjitalizimi i faturimit të detyrimit dhe përmirësimi i sistemit të arkëtimit/ pagesave*
- M 4.2.5 Integrimi elektronik i shkëmbimit të të dhënave me agjentët e mbledhjes së tarifave/ ShaUK.*

M 4.2.6 Hartimi i një programi ndërgjegjësues për rëndësinë e pagesës së shërbimit të përfituar

4.3.5 Objektivi strategjik 5: Forcimi i kulturës së reduktimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe bizneseve

Bashkia Tepelenë do të ndjekë një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për forcimin e kulturës së reduktimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve. Informimi, edukimi dhe pjesëmarrja aktive e komunitetit janë faktorë kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e mjedisit. Duke qenë se bashkia karakterizohet nga një territor i gjerë ku përfshihen dhe zonat rurale me një potencial të rëndësishëm turistik dhe natyror, kjo qasje synon të krijojë një kulturë të përbashkët përgjegjësie për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë territorin administrativ.

Në këtë kuadër, bashkia do të forcojë komunikimin dhe bashkëpunimin me qytetarët, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore, përmes konsultimeve periodike në qytetin e Tepelenës dhe njësitë administrative, si dhe duke përdorur kanale të ndryshme informimi dhe raportimi. Kjo qasje do të mundësojë identifikimin në kohë të problematikave, rritjen e transparencës mbi ofrimin e shërbimit dhe përfshirjen e komunitetit në procesin e monitorimit dhe përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edukimit mjedisor, ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe nxitjes së praktikave të përditshme të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve. Bashkia do të zhvillojë programe të vazhdueshme informuese dhe edukative, të përshtatura për grupmosha dhe kategori të ndryshme të popullsisë, duke përfshirë fushata publike, aktivitete në shkollë, materiale informuese dhe iniciativa komunitare. Këto masa synojnë të nxisin ndryshimin e sjelljes së qytetarëve dhe të krijojnë një kulturë të qëndrueshme të mbrojtjes së mjedisit.

Për të rritur ndikimin e aktiviteteve të Planit, bashkia do të promovojë partneritete me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në fushën e ekonomisë qarkulluese. Do të mbështeten veçanërisht nismat për ndarjen e mbetjeve në burim, zgjerimin e riciklimit, organizimin e aktiviteteve vullnetare të pastrimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e zonave me vlera të larta natyrore dhe turistike, përfshirë luginën e lumit Vjosë, Parkun Kombëtar të Vjosës dhe atraksionet kryesore të bashkisë.

Ky objektivi strategjik mbështet zbatimin e të gjitha objektivave të tjera të Planit. Reduktimi i mbetjeve, ndarja në burim, rritja e riciklimit, përmirësimi i mbledhjes së tarifave dhe eliminimi i depozitimeve të paligjshme nuk mund të arrihen vetëm përmes investimeve në infrastrukturë, por kërkojnë edhe ndryshim të sjelljes së qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve. Për këtë arsye, komunikimi, edukimi dhe pjesëmarrja aktive e komunitetit përbëjnë elemente thelbësore për suksesin afatgjatë të sistemit vendor të menaxhimit të mbetjeve.

Për të garantuar efektivitetin e kësaj qasjeje, bashkia do të monitorojë periodikisht zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave përmes treguesve të performancës që lidhen me nivelin e informimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit, përfshirjen e institucioneve, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe progresin në ndarjen në burim dhe riciklimin e mbetjeve. Rezultatet e monitorimit do të përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe masave të Planit, ndërsa treguesit e detajuar paraqiten në Kapitullin e Monitorimit.

4.3.5.1 Objektivi specifik 5.1: Të forcohen mekanizmat e komunikimit, konsultimit dhe monitorimit ndërmjet bashkisë, komunitetit dhe bizneseve për përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.

Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve kërkon një komunikim të vazhdueshëm dhe të strukturuar ndërmjet bashkisë, komunitetit dhe bizneseve. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në identifikimin e problematikave, konsultimin e politikave vendore dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimit kontribuon në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë institucionale dhe besimit ndaj administratës vendore. Në këtë kuadër, Bashkia Tepelenë do të zhvillojë një sistem të integruar komunikimi, konsultimi dhe monitorimi, i mbështetur në publikimin e rregullt të informacionit mbi shërbimin, organizimin e forumeve me komunitetin dhe bizneset, krijimin e mekanizmave të raportimit të problematikave dhe vlerësimin periodik të kënaqësisë së qytetarëve.

Komunikimi me publikun do të bazohet në parimet e transparencës, aksesit të barabartë në informacion, konsultimit publik dhe llogaridhënies, në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore dhe të drejtën e informimit. Për të rritur transparencën, bashkia do të publikojë rregullisht informacion mbi organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, përfshirë pikat e grumbullimit të mbetjeve, kalendarin e grumbullimit, zonat e mbuluara, rezultatet e monitorimit dhe treguesit kryesorë të performancës. Informacioni do të shpërndahet përmes faqes zyrtare, rrjeteve sociale, tabelave të njoftimeve dhe kanaleve të tjera lokale.

Bashkia do të organizojë takime periodike me qytetarët në qytetin e Tepelenës dhe në njësitë administrative, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile. Këto forume do të shërbejnë për prezantimin e performancës së shërbimit, diskutimin e rezultateve të monitorimit, identifikimin e problematikave lokale, mbledhjen e propozimeve për përmirësimin e shërbimit dhe forcimin e dialogut ndërmjet administratës vendore, komunitetit dhe aktorëve të tjerë lokalë. Takimet do të zhvillohen çdo 6 muaj në katër njësitë administrative (Tepelenë, Qendër Tepelenë, Kurvelesh dhe Lopës).

Bashkia do të zhvillojë takime periodike me bizneset lokale, të paktën një herë në vit, veçanërisht me subjektet që gjenerojnë sasi të konsiderueshme mbetjesh ose operojnë në sektorin e turizmit dhe shërbimeve, si hotelet, restorantet, por edhe subjekte të tjera tregtare të shitjes me pakicë. Konsultimet do të synojnë identifikimin e nevojave, promovimin e praktikave të mira dhe krijimin e partneriteteve për përmirësimin e menaxhimit dhe riciklimit të mbetjeve. Në konsultime do të ftohen të marrin pjesë edhe operatorët ekonomikë të riciklimit, me synim identifikimin e mundësive për bashkëpunim dhe zhvillimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese në territorin e bashkisë.

Bashkia do të krijojë mekanizma të thjeshtë dhe të aksesueshëm për raportimin e problematikave nga qytetarët, përmes linjës telefonike, adresës elektronike, platformave online ose formularëve të dedikuar. Çdo raportim do të regjistrohet, klasifikohet sipas tipologjisë së problematikës dhe do të ndiqet deri në zgjidhjen e tij, duke mundësuar monitorimin e kohës së reagimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit.

Çdo vit bashkia do të zhvillojë anketa për të vlerësuar nivelin e kënaqësisë së qytetarëve ndaj shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Rezultatet e anketave do të analizohen dhe do të përdoren si pjesë e sistemit të monitorimit të performancës së shërbimit, për identifikimin e prioritetëve, përmirësimin e planifikimit dhe vlerësimin periodik të efektivitetit të masave të Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve.

Zbatimi i këtij objektivi do të krijojë një model të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërmjet bashkisë, komunitetit, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile, duke forcuar transparencën, besimin

publik dhe pjesëmarrjen aktive të aktorëve lokalë në planifikimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Masat:

M 5.1.1 Organizimi i forumeve periodike komunitare

M 5.1.2 Krijimi i mekanizmave të raportimit të problematikave

M 5.1.3 Publikimi periodik i informacionit mbi shërbimin

M 5.1.4 Organizimi i konsultimeve me bizneset

M 5.1.5 Realizimi i anketave të kënaqësisë së qytetarëve

4.3.5.2 Objektivi specifik 5.2: Të rritet niveli i informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve për reduktimin, ndarjen e mbetjeve në burim dhe mbrojtjen e mjedisit.

Zbatimi i këtij objektivi do të kontribuojë në ndryshimin e sjelljes së qytetarëve ndaj menaxhimit të mbetjeve, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në praktika të qëndrueshme, si reduktimi i mbetjeve, ndarja në burim dhe ruajtja e pastërtisë së mjedisit. Kjo pritet të mbështesë përmirësimin e performancës së sistemit vendor të menaxhimit të mbetjeve dhe cilësisë së mjedisit. Objektivi mbështet drejtpërdrejt zbatimin e masave për ndarjen në burim, riciklimin, reduktimin e depozitimit dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shërbimit.

Bashkia do të hartojë një program të strukturuar të edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor, i cili do të përcaktojë temat, grupet e synuara, format e komunikimit dhe kalendarin vjetor të aktiviteteve. Programi do të shërbejë si instrument për koordinimin e të gjitha nismave informuese dhe edukative në territorin e bashkisë. Programi do të përputhet me kalendarin e ditëve të shënuara mjedisore ndërkombëtare, si Dita e Tokës në 22 prill, Dita Globale e Riciklimit në 18 mars, Dita Ndërkombëtare për Zero Mbetje në 30 mars, Dita Botërore e Mjedisit 5 qershor, Dita Botërore e Pastrimit të shtunën e tretë të muajit shtator, etj.

Për tematika dhe grupe të ndryshme të synuara do të hartohen mesazhe të përshtatura komunikimi, me fokus përgjegjësinë qytetare, reduktimin e mbetjeve, ndarjen në burim, riciklimin, mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm. Mesazhet do të përshtaten sipas audiencës (fëmijë, të rinj, familje, biznese dhe vizitorë), duke përdorur forma të ndryshme komunikimi.

Do të ngrihet Grupi Koordinues për Edukimin dhe Komunikimin Mjedisor, i përbërë nga përfaqësues të bashkisë dhe institucioneve/aktorëve të tjerë, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e planit të komunikimit, koordinimin e fushatave ndërgjegjëse, përgatitjen e materialeve informuese, organizimin e aktiviteteve me komunitetin, shkollat dhe bizneset, si dhe monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin e rezultateve të aktiviteteve të ndërgjegjësimit.

Do të organizohen fushata të vazhdueshme informimi dhe ndërgjegjësimi në qytetin e Tepelenës dhe në njësitë e tjera administrative për të promovuar reduktimin e mbetjeve, ndarjen në burim, riciklimin dhe mbrojtjen e mjedisit, të paktën 2 fushata në vit. Fushatat do të përdorin kanale të ndryshme komunikimi për të arritur tek të gjitha grupet e audiencës, duke përfshirë median lokale RTSH Gjirokastra, median sociale të bashkisë, takimet publike me qytetarët dhe bizneset dhe publikimin e materialeve promovuese.

Në bashkëpunim me institucionet arsimore do të hartohet dhe realizohet një program edukativ për reduktimin dhe menaxhimin e mbetjeve, i cili do të përmbajë aktivitete edukative mbi

menaxhimit të mbetjeve, orë informuese, konkurse, ekspozita, aksione pastrimi dhe iniciativa të riciklimit kreativ. Si pjesë e programit do të organizohet çdo vit konkursi "3R" ndërmjet shkollave ku nxënësit do të prezantojnë projekte, punime artistike ose zgjidhje praktike që promovojnë reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve. Punimet më inovative dhe me ndikimin më të madh edukues do të vlerësohen me çmime, duke nxitur kreativitetin dhe përfshirjen aktive të rinjve në mbrojtjen e mjedisit. Synimi është të ndërtohet një kulturë mjedisore që në moshë të hershme dhe të përfshihen edhe familjet përmes nxënësve.

Bashkia do të përgatisë dhe vendosë materiale informuese, të tilla si postera, tabela informuese, etj. në pikat me frekuentim të lartë, si qendra e qytetit, shkollat, tregu, institucionet publike dhe zonat turistike. Këto materiale të printuara në format të madh do të ofrojnë udhëzime praktike për ndarjen e mbetjeve, përdorimin e infrastrukturës së grumbullimit dhe rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit. Krahas kësaj do të prodhohen dhe fletëpalosje me qëllim informues dhe ndërgjegjësuës për t'u shpërndarë tek qytetarët.

Duke qenë se Tepelena po orienton zhvillimin drejt turizmit natyror dhe kulturor, gjatë sezonit turistik, bashkia do të organizojë fushata të posaçme informuese në zonat me fluks vizitorësh, me qëllim promovimin e sjelljeve të përgjegjshme ndaj mjedisit, veçanërisht në Parkun Kombëtar të Vjosës, luginën e lumit Vjosë dhe atraksionet kryesore turistike të bashkisë. Aktivitetet do të synojnë respektimin e natyrës, mbajtjen pastër të zonave natyrore dhe turistike dhe minimizimin e mbetjeve duke inkurajuar vizitorët dhe operatorët turistikë të reduktojnë gjenerimin e mbetjeve dhe të përdorin infrastrukturën e dedikuar.

Zbatimi i këtij objekti pritët të krijojë një kulturë të qëndrueshme mjedisore në komunitet, duke rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, institucioneve arsimore, bizneseve dhe vizitorëve në reduktimin e mbetjeve, ndarjen në burim dhe mbrojtjen e mjedisit. Rezultatet do të monitorohen periodikisht përmes treguesve të përcaktuar në kapitullin e monitorimit të Planit.

Masat:

M 5.2.1 Hartimi dhe zbatimi i Programit të Edukimit dhe Ndërgjegjësimit Mjedisor

M 5.2.2 Ngritja e një Grupi Koordinues për Edukimin dhe Komunikimin Mjedisor për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuëse sipas Programit

M 5.2.3 Organizimi i fushatave periodike të informimit dhe ndërgjegjësimit.

M 5.2.4 Zhvillimi i programeve edukative dhe aktiviteteve praktike në institucionet arsimore.

M 5.2.5 Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e materialeve informuese.

M 5.2.6 Fushata ndërgjegjësuëse në zonat turistike

4.3.5.3 Objekti specifik 5.3: Të rritet pjesëmarrja e bizneseve, institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit në iniciativat për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve.

Arritja e objektivave të Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve kërkon pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve lokalë. Përveç rolit të bashkisë, bizneset, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti kanë një rol të rëndësishëm në reduktimin e mbetjeve, ndarjen në burim dhe zhvillimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese. Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë

do të promovojë partneritete dhe iniciativa të përbashkëta që nxisin përgjegjësinë e përbashkët dhe angazhimin e komunitetit në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

Bashkia do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me bizneset dhe operatorët ekonomikë për përmirësimin e grumbullimit dhe riciklimit të mbetjeve të riciklueshme. Partneritetet do të mbështesin zhvillimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese dhe rritjen e sasisë së materialeve të rikuperuara.

Për të testuar dhe demonstruar praktikën e ndarjes së mbetjeve në burim, Bashkia do të zbatojë projekte pilot në institucione publike, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe në biznese dhe zona të përzgjedhura urbane. Përvoja e fituar do të shërbejë për përmirësimin e modelit të zbatimit dhe zgjerimin gradual të sistemit në të gjithë territorin e bashkisë.

Në bashkëpunim me komunitetin, shkollat, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset, Bashkia do të organizojë periodikisht, të paktën dy herë në vit, aktivitete vullnetare për pastrimin e hapësirave publike, të qendrave të fshatrave, të zonave turistike dhe brigjeve të lumit Vjosë. Këto iniciativa synojnë jo vetëm përmirësimin e gjendjes mjedisore, por edhe forcimin e përgjegjësisë qytetare.

Bashkia do të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile aktive në territor, përfshirë shoqatën kulturore "Vatra" për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve komunitare që promovojnë edukimin mjedisor, reduktimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Ky bashkëpunim do të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe në zgjerimin e ndikimit të fushatave ndërgjegjëse.

Bashkia do të krijojë një program vullnetar për njohjen dhe promovimin e bizneseve që zbatojnë praktikën e mira mjedisore, si reduktimi i mbetjeve, ndarja në burim, përdorimi i materialeve të riciklueshme dhe mbështetja e iniciativave lokale për mbrojtjen e mjedisit. Programi "Biznesi i Gjellbër i Tepelenës" do të shërbejë si instrument motivues për rritjen e përgjegjësisë sociale të biznesit dhe nxitjen e praktikave të ekonomisë qarkulluese.

Bashkia do të organizojë çdo vit "Javën e Mjedisit", si një program aktivitetsesh që do të përfshijë ekspozita, konkurse, panairë riciklimi, aksione pastrimi dhe aktivitete edukative me pjesëmarrjen e shkollave, grupeve rinore, bizneseve, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit. Kjo nismë synon të promovojë kulturën e mbrojtjes së mjedisit dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve lokalë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. "Java e Mjedisit" do të shërbejë gjithashtu si platformë për prezantimin e rezultateve të arritura gjatë vitit dhe promovimin e praktikave të mira të komunitetit dhe bizneseve.

Masat:

M 5.3.1 Pilotimi i ndarjes së mbetjeve në burim

M 5.3.2 Krijimi i partneriteteve me bizneset dhe operatorët ekonomikë për promovimin e ekonomisë qarkulluese

M 5.3.3 Organizimi i aktiviteteve komunitare të pastrimit

M 5.3.4 Krijimi i programit "Biznesi i Gjellbër i Tepelenës"

M 5.3.5 Mbështetja e iniciativave të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve komunitare

M 5.3.6 Organizimi i "Javës së Mjedisit" në Tepelenë

5. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit përbën instrumentin kryesor për zbatimin e objektivave strategjike të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Ai përmban masat konkrete (të listuara në fund të secilit prej objektivave specifike), afatet e zbatimit, strukturat përgjegjëse, burimet e mundshme të financimit dhe indikatorët për monitorimin e progresit. Këto masa synojnë përmirësimin gradual të performancës së sistemit të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me objektivat e legjislacionit kombëtar, parimet e ekonomisë qarkulluese dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Plani i Veprimit shërben për të siguruar një zbatim të koordinuar, të matshëm dhe financiarisht të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës 2026–2031. Plani i Veprimit paraqitet i plotë në Matricën e objektivave dhe masave, së bashku me treguesit përkatës dhe nevojat për financim.

6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

5.1 Qëllimi dhe kuadri i monitorimit

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve synojnë të sigurojnë ndjekjen sistematike të zbatimit të objektivave, masave dhe aktiviteteve të planit, si dhe të vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e sistemit vendor të menaxhimit të mbetjeve.

Ky proces mbështet vendimmarrjen e bashkisë, identifikimin në kohë të problematikave, përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, rritjen e transparencës dhe përmbushjen e detyrimeve të raportimit ndaj institucioneve përgjegjëse.

Monitorimi dhe raportimi do të zhvillohen në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i cili përcakton përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për planifikimin, monitorimin dhe raportimin e performancës së sistemit vendor të menaxhimit të mbetjeve, në koordinim me institucionet kombëtare përgjegjëse.

5.2 Organizimi institucional

Përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Planit i takon Bashkisë Tepelenë, përmes strukturës përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Procesi i monitorimit do të realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të bashkisë (Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Pastrimit, Sektori i Informimit), njësitë administrative, institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile, partnerët privatë dhe institucionet kombëtare përgjegjëse, sipas kompetencave të tyre.

Bashkia do të caktojë një koordinator përgjegjës për mbledhjen, verifikimin, analizimin dhe konsolidimin e të dhënave të monitorimit, si dhe për përgatitjen e raporteve periodike.

5.3 Treguesit e monitorimit

Përzgjedhja e treguesve është bërë në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve dhe raportimin statistikor, duke u bazuar në kërkesat e Ligji nr. 57/2025, aktet nënligjore për statistikën e mbetjeve dhe monitorimin e performancës së shërbimeve vendore, si dhe metodologjitë e zhvilluara në kuadër të programit Bashki të Forta, të cilat promovojnë përdorimin e treguesve të standardizuar për matjen dhe përmirësimin e performancës së bashkive.

Në përputhje me këto parime, sistemi i treguesve mbështetet në disa kritere themelore: treguesit duhet të jenë të matshëm, të verifikueshëm, të krahasueshëm ndër vite, të bazuar në burime zyrtare të të dhënave dhe të lidhur drejtpërdrejt me objektivat dhe masat e Planit. Të

dhënat do të mblidhen në mënyrë periodike nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, institucionet publike dhe burime të tjera zyrtare, duke garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit mbi të cilin mbështetet monitorimi.

Monitorimi do të mbështetet në tregues sasiore dhe cilësore, të organizuar sipas katër grupeve kryesore:

- *Tregues teknikë* që matin performancën operative të sistemit (mbulimi me shërbim, sasia e mbetjeve të grumbulluara, riciklimi, infrastruktura dhe depozitimet e paligjshme);
- *Tregues financiarë* që matin kostot e shërbimit, nivelin e mbulimit të kostove, normën e arkëtimit të tarifave dhe investimet në sektor;
- *Tregues institucionalë* që vlerësojnë realizimin e aktiviteteve, funksionimin e mekanizmave të koordinimit, partneritetet dhe zbatimin e masave të Planit;
- *Tregues të komunikimit dhe ndërgjegjësimit* që matin nivelin e informimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, numrin e aktiviteteve të zhvilluara, përfshirjen e shkollave, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe progresin në ndarjen e mbetjeve në burim.

Treguesit e detajuar të monitorimit dhe vlerat e synuara për secilin objektiv paraqiten në matricën e monitorimit të Planit.

Të dhënat do të sigurohen nga strukturat përgjegjëse të bashkisë, operatori i shërbimit të pastrimit, sistemi financiar i bashkisë, raportet e monitorimit, anketat me qytetarët, procesverbalet e konsultimeve publike, raportimet e partnerëve institucionalë dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe nga të dhënat e institucioneve kombëtare përgjegjëse.

Monitorimi do të shoqërohet me raportim periodik sipas ciklit të mëposhtëm:

Raporti

Frekuenca

Raport i brendshëm i progresit

çdo 6 muaj

Raport vjetor i monitorimit

çdo vit

Vlerësim afatmesëm

në mesin e periudhës së Planit

Vlerësim përfundimtar

në fund të periudhës së Planit

Raportet do t'i paraqiten Këshillit Bashkiak dhe do të publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë, me qëllim garantimin e transparencës dhe informimit të publikut.

Vlerësimi afatmesëm do të analizojë progresin drejt arritjes së objektivave dhe, nëse është e nevojshme, do të propozojë rishikimin e prioriteteve, aktiviteteve ose burimeve. Në përfundim të periudhës së Planit do të realizohet vlerësimi përfundimtar, i cili do të analizojë nivelin e arritjes së objektivave, ndikimin e Planit dhe rekomandimet për planin pasardhës.

Monitorimi dhe vlerësimi nuk do të konsiderohen vetëm procese raportimi, por instrumente të menaxhimit të performancës dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit. Rezultatet e monitorimit do të përdoren për rishikimin e planit, rritjen e efikasitetit në përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore, përmirësimin e organizimit të shërbimit dhe përshtatjen e masave ndaj ndryshimeve në legjislacion, zhvillimeve teknologjike dhe nevojave të komunitetit.

Do të caktohet një koordinator përgjegjës për mbledhjen, konsolidimin dhe analizimin e të dhënave.

Bashkia Tepelenë

Raportet do të prezantohen në Këshillin Bashkiak dhe do të publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë për të garantuar transparencën dhe informimin e publikut.